

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7657 E enjte 20 Shtator 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Raportimi

Ditës

Nga LINDITA ÇELA

Lirimi i Ermal Hoxhës,
"përplasje" avokat-prokurori



Dje

në "Ekspress"

Nga ALBIONETA ADEMI

Intrigat e takimit të Vjenës
për ndarjen e Kosovës

Jetë mesjatore për ndarje etnike,
dësa përfaqësues të rëndësishëm
të shoqërisë civile nga Ballkani,
por edhe nga vendet e Bashkimit
Evropian ...

Raportet pozitive nga institucionet
e drejtësisë dhe një kontratë pune
me kompaninë e bashkëshortes së tij
i hapën rrugën vendimit të lirimit me
kusht të Ermal ...

Vijon në faqen 20

Vijon në faqen 21



Tiranë/ 4 të panjohur rrahin Andrea Zogën

Dhunohet biznesmeni: Po paguaj borxhet e vëllait, dua drejtësi ose iki nga Shqipëria

Rrëfimi nga spitali: Më kanë kërcënuar
edhe herë të tjera. Berisha: Narkoshtet!

INA ALLKANJARI

Biznesmeni Andrea Zoga, i njohur në Tiranë në fushën
e restoranteve dhe "fast food"-eve ka mbetur i lënduar
mesnatën e së martës, pasi persona ende të pidentifikuar
e kanë dhunuar. Ngjarja në fjalë ka ndodhur në Rrugën

Në faqen 5

EMRAT/ LISTA ME VENDIMET E GJYKATAVE DHE DOKUMENTET QE MUNGOJNE

ATP: PROBLEMET ME 8 MIJE DOSJET E REJA TE PRONAVE

Agjencia e Trajtitimit të Pronës përditëson regjistrin e pronarëve që presin
kompensim në vitet 1993-2014. Sipërfaqja e pretenduar dhe sipërfaqja e njohur



(Në foto) Toka

Në faqet 2-5

FLET 27-VJEÇARI

Dhimbja e jetimit:
Në Shkodër na linin
pa bukë dhe na
lidhnin me zinxhirë

Në faqen 11

DIPLOMACIA

Ministri i Jashtëm
gjerman dhe zyrtarja
e SHBA në Tiranë:
Vazhdoni reformat

Në faqen 3

DURRES

Kontrabandë
cigaresh me
autoambulancë,
2 vetë në pranga

Në faqen 13

INTERVISTA

Rrëfimi i Joni
Peçit: Zoti dhe
prindërit nuk të
tradhtojnë kurrë

Suplement

PERPLASJA



Opozita mblidhet
sot në Vlorë, PD
letër Ruçit: 'Teatri'
shkel Kushtetutën

Në faqen 2

In memoriam/ 20-vjetori i vdekjes së poetit, familja: Kohët kur këndonte Beatles

E bija e Alqi Boshnjakut: "Pengjet" me babain

Amoela: Më dhuronte libra dhe kujtimet e porosive të tij për punën

NGA FATMIRA NIKOLLI

Kur isha e vogël, më tho-
shin që babai im, Alqi
është poet shumë i njohur.
Atëherë nuk e rrokja mad-
hështinë e tij. E kuptova me
të vërtetë forcën e penës së
tim eti, vetëm kur takohesha
me shqiptarë në Greqi dhe



prezantohesha si e bija. Shi-
koja në sytë e tyre respekt
dhe admirim për tekstet e
këngëve që krijoi". Amoela
Boshnjaku ndjen boshllëk
kur kanë kaluar 20 vite pa të
atin. Poeti e tekstshkruesi i
nda nga jeta më 20 shtator të
vitit 1998, ende i ri ...

Në faqet 18-19

TEATRI KOMBETAR

DEBATI

Valentina Madani

Kuvendi mblidhet sot në seancë parlamentare, ndërkohë që opozita e bashkuar po në të njëjtën orë do të jetë në Vlorë. Ora 10:00 do e gjejë mazhorancën dhe opozitën parlamentare në dy destinacione të ndryshme. Mazhoranca do të votojë e vetme dekretin e Presidentit Ilir Meta për "Teatrin" bashkë me ndryshimet ligjore, ndërsa PD dhe aleatët e saj kanë zgjedhur Vlorën dhe jo parlamentin, sipas tyre për të qëndruar atje ku njerëzit janë të rrezikuar dhe të pasigurt nga bandat dhe jo në godinën ku bandat përfaqësohen nga qeveria. Të martën, dekreti presidencial kaloi vetëm me votat e të majtëve në Komisionin Parlamentar të Veprimtarisë Prodhuese. Opozita e cilësoi votimin antikush-tetues, pasi sipas saj, pranimi i dekretit e bën nul ligjin, ndërsa socialistët u mbrojtën duke sjellë në vëmendje precedentë të mëparshëm parlamentarë.

TAKIMI
Kreu i PD-së, Lulzim Basha pas një takimi me artistët në selinë e PD-së u bëri thirrje të gjithë deputetëve që sot të mos e votojnë ligjin për rrëzimin e Teatrit Kombëtar. Sipas tij, çdo deputet që do të ngrejë lart kartonin, do të trajtohet si një akt terrorist shtetëror. "Sot kam pritje përfaqësues të nderuar të Aleancës për Teatrin, artistë e intelektualë të shquar, njerëz me kontribut të jashtëzakonshëm për dekada me radhë, për artin, për kulturën, për vetëdijen e shqiptarëve, përfaqësues të elitës së mendjes dhe të shpirtit të shqiptarëve, të cilët ndajnë një shtetësimi i madh, që është edhe shtetësimi i qindra dhe mijëra qytetarëve të Tiranës dhe mbarë Shqipërisë, ardashësve dhe padyshim edhe shtetësimi i PD-së dhe i imi personalisht. Nesër në Kuvendin e Shqipërisë do të kryhet një akt antikush-tetues", theksoi kreu i PD-së. Gjithashtu, Basha deklaroi se po shkatërrohet historia, kultura dhe trashëgimia kulturore e vendit nga krimi dhe korrupsioni qeveritar: "Në vend të rrëzimit apo pranimit të dekretit të Presidentit të Republikës për ligjin korruptiv Rama-Fusha, do të amendohet ky ligj për t'i hapur rrugën një procesi fasadë, 30-ditor. Në fund të së cillit krimi i organizuar dhe përfaqësues të tyre përsëri do të marrin lejen për të gllabëruar pronën publike, për të shkatërruar një perlë të kulturës, historisë, trashëgimisë kulturore dhe memories qytetare dhe kombëtare siç është rrethi kulturor Skënderbe-Teatrit Kombëtar dhe për të pas-

Opozita mblidhet sot në Vlorë, PS voton dekretin e Metës. Kreu i PD: Grusht shteti

Ligji për Teatrin në Kuvend, Basha: Terrorist, çdo deputet që e voton Opozita, letër Ruçit: Po shkelet Kushtetuta



Kreu i PD-së, Lulzim Basha, dje pas takimit me artistët në selinë e PD-së

NJOFTIMI

Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit ka bërë me dije mbrëmë vonë se sot do të protestojë para parlamentit në kundërshtim të ligjit antikush-tetues që rremben pronën publike e shkatërron teatrin

Sot në Kuvend ligji për Teatrin, Rama dhe Veliaj takojnë Ruçin

Një ditë para seancës plenare ku pritet të votohet dekreti i presidentit, që ktheu për rishqyrtim ligjin për Teatrin e ri Kombëtar, zyrën e kryetarit të Kuvendit e vizituan kryeministri Edi Rama, kryebashkiaku Erjon Veliaj, shefja e kabinetit të kryeministrit Vali Bizhga, sekretari i përgjithshëm të Këshillit të Ministrave Engjëll Agazi, si dhe relatori i këtij ligji që u amendua nga mazhoranca, Ilir Beqaj. Takimi zgjati rreth 60 minuta dhe nuk pati asnjë informacion zyrtar pas tij. Por burime nga takimi konfirmuan se qëllimi ishte pikërisht për të diskutuar mbi këtë votim në seancën e së enjtes. Gjithashtu, gjatë seancës së sotme plenare është parashikuar në rend dite edhe raportimi i kryeprokurores Arta Marku. Për herë të parë që prej marrjes së detyrës, Arta Marku do të pasqyrojë përpara deputetëve punën e prokurorisë për vitin 2017.

truar paratë e krimet e drogës në një përfitim marramendës prej 200 milionë eurosh për Edi Ramën dhe bashkëpunëtorët e tij në këtë krim", shtoi Basha. Të gjitha ata që votojnë sot në parlament pro prishjes së Teatrit, Basha i paraljmëroi: "PD ka një qellim të qartë dhe të pandryshuar. Ligji Rama-Fusha' duhet të rrezohet nesër në parlament, dua t'i them çdo deputeti që rrëzimi i Teatrit është një akt barbar. Ata duan të tjetërsojnë, gllabërojnë pronën publike. Sonte u bëj thirrje të gjithë karton-

mbajtësve, që sot çdokush që ngre kartonin, do të trajtohet politikisht nga opozita si terrorist shtetëror".

LETRA

Opozita e bashkuar i kërkoi kryetarit të Kuvendit të mos përfshijë në seancën e së enjtes ligjin për Teatrin. Kryetarët e grupeve të PD dhe LSI, Edmond Spaho dhe Petrit Vasili i kanë dërguar një letër kryetarit të Kuvendit, Gramoz Ruçi duke i kërkuar që të mos pranohet nesër në seancë plenare që të miratohen ndryshimet në ligjin për Teatrin Kombëtar.

PARALAJMËRIMI

"Ligji Rama-Fusha, duhet të rrezohet nesër në Parlament, dua t'i them çdo deputeti, që rrëzimi i Teatrit është një akt barbar. Ata duan të tjetërsojnë, gllabërojnë pronën publike. Sonte u bëj thirrje të gjithë kartonmbajtësve, që sot çdo kush që ngre kartonin, do të trajtohet politikisht nga opozita si terrorist shtetëror", tha z.Basha.

Vasili dhe Spaho kërkojnë nga Ruçi që nesër të votohet vetëm dekreti i Presidentit Meta 'pro' që rrëzon ligjin për Teatrin Kombëtar, por jo varianti i ri me ndryshimet që ka propozuar shumica dhe që kaloi dy ditë më parë Komisionin e Veprimtarisë Prodhuese. PD dhe LSI e cilësojnë shkelje procedurë parlamentare që ndoqi shumica për të amenduar dekretin. Sipas tyre, me votimin pro të dekretit të Metës, ligji ra dhe për të miratuar një ligj të ri, procedura duhet që të fillojë nga e para, pra nisim të dorëzohet nga një grup deputetësh, të futet në kalendar dhe më pas të kalohet në komisione për shqyrtim dhe në fund në parlament. Një praktikë e tillë, sipas opozitës nuk i heq të drejtën presidentit për të vendosur veton mbi ligjin, pasi me procedurën që po ndiqet aktualisht, i hiqet. Spaho dhe Vasili vënë në dukje se, në kushtet kur komisioni përgjegjës pranoi dekretin, i vetmi veprim që duhet të kryejë Kuvendi në përputhje me Kushtetutën dhe rregulloren është votimi pro i dekretit dhe kthimi i ligjit mbrapsht në qeveri. "Kuvendi nuk mund të rimiratojë të njëjtin ligj me përmbajtje të ndryshuar në vetëm pak dispozita të tij dhe vetëm për një element. Votimi 'pro' dekretit të Presidentit të Republikës në këtë rast pamundëson prezantimin e çdo ndryshimi të mundshëm në ligj, për shkak se ligji është rrezuar në tërësinë e tij", thuhet në letrën e opozitës.



Gjatë një seance parlamentare

ERVIN SALIANJI

"Ne kemi paralajmëruar që Teatri nuk do të preket. Me ligj apo pa ligj, kjo është vjedhje e kryeministrit prej miliona eurosh. Ne mendojmë që prona publike nuk duhet të tjetërsohet. Aty ndodh shkelje e pastër, me apo pa garë. Ne mendojmë që Teatri të rikonstruktohet aty ku është. Ti nuk është se nuk ke para, por po e bën për të vjedhur pronën publike", deklaroi z.Salianji në "News 24".

SHKURTE

"Ligji i Teatrit", Vasili ultimatum Ruçit: Ndali hajdutët e pronës

Kreu i grupit parlamentar të LSI-së, Petrit Vasili, deklaroi dje se votimi i Ligjit të Teatrit në Komisionin e Veprimtarisë Prodhuese është akti që tregon fundin e parlamentit. Vasili shkruan në "Facebook" se tashmë e gjitha situata është në dorë të Gramoz Ruçit, që të shpëtojë institucionin e parlamentit nga gërmadha. Sipas tij, kreu i Kuvendit duhet të tregojë se është përfaqësues i shoqërisë dhe jo i kusarëve. "Ligji i Teatrit dhe votimi antikush-tetues në Komisionin e Veprimtarisë Prodhuese është fundi i parlamentit. Gramoz Ruçi ka shansin e fundit për të mos lejuar gërmadhen e parlamentit, që të shembet krejtësisht", shkruan kreu i deputetëve të PD-së.

Vetingu i politikanëve, Këshilli i Legjislacionit mblidhet në 26 shtator

Kreu i Kuvendit, Gramoz Ruçi ka vendosur të mblidhë në datën 26 shtator në orën 12:00 Këshillin e Legjislacionit, për të diskutuar mbi nismën e PD në lidhje me vetingun e politikanëve. Grupi parlamentar i PD i kërkoi zyrtarisht kryeparlamentarit Ruçi që Këshillin ta mblidhë ditën e premte, por ky i fundit ka vendosur për të mërkurën e javës së ardhshme. Dy ditë më parë në një bashkëbisedim me gazetarët, kreu i opozitës, Lulzim Basha deklaroi se vetingu i Partisë Socialiste për vetingun politik është vija e kuqe që do të përcaktojë sjelljen e opozitës me institucionet, përfshirë edhe zgjedhjet e ardhshme vendore. Demokratët nuk e kanë ndërmend të pranojnë kërkesën e kryeministrit Edi Rama që për këtë çështje të marrin mendimin e "Venecias", duke e konsideruar si alibi për të shtyrë dhe për t'u shmangur procesit.



DITMIR BUSHATI

Ministri i Jashtëm shqiptar deklaroi dje, se për opozitën janë bërë oferta në lidhje me ato çështje që konsiderohen çështje të përbashkëta, ka një ofertë tjetër për të mbështetur procesin e vetingut e po kështu një tjetër ofertë për përmblylljen e reformës zgjedhore. Bushati tha se ka edhe një ofertë tjetër për opozitën sa i përket votimit për shkollën e magistraturës. "Dialogu dhe thirrjet për bashkëpunim nuk do të mungojnë", -tha Bushati.



Zv/ndihmës sekretarja e SHBA, tri ditë në Tiranë

Meta pret Millard: Me rëndësi ecuria e reformave për të forcuar shtetin

Presidenti i Republikës Ilir Meta priti dje, në takim zëvendës/ndihmësen e Sekretarit Amerikan të Shtetit, znj. Elisabeth Millard. Të dy bashkëbiseduesit vlerësuan rëndësinë e ecurisë së reformave për të forcuar shtetin e së drejtës në interes të konsolidimit të ligjit, si dhe të integritimit evropian. Presidenti Meta garantoj znj. Millard se Shqipëria është e vendosur në përmbushjen e detyrimeve që burojnë nga dokumenti i Partneritetit Strategjik Shqipëri-SHBA. Gjatë takimit u diskutua edhe për zhvillimet në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Presidenti Meta theksoi rëndësinë e finalizimit të dialogut Kosovë-Serbi përmes marrëveshjes që garanton perspektivën evropiane, konsolidon bashkëjetesën ndëretnike dhe paqen në rajon. Meta e zyrtarja e lartë e DASH theksuan rëndësinë e suksesit të referendumit në Maqedoni për të ardhmen evropiane të të gjithë rajonit. Ndihamës sekretarja amerikane u takua dje edhe me kreun e PD-së, Lulzim Basha, i cili sipas njoftimit për shtyp të PD-së e njohu zyrtaren me përkeqësimin e të gjitha standardeve të demokracisë dhe kapjen e shtetit nga krimi i organizuar në Shqipëri. Lideri i opozitës vuri në dukje se, ndonëse ligji i dekriminalizimit, që u realizua falë këmbënguljes dhe vendosmërisë së PD, nxori jashtë institucioneve 333 persona me rekorde kriminale, sot lidhja krim-politike ka gjetur forma të tjera për të qenë në krye të institucioneve vendimmarrëse nga Kuvendi dhe qeveria, në bashki, polici e kudo. Kreu i opozitës shprehu vendosmërinë për t'i shkruar deri në fund pastrimit të politikës nga krimi duke kërkuar ndihmën dhe mbështetjen edhe të SHBA në këtë proces jetik për vendin dhe të ardhmen e vendit.

Kryeministri kërkon mbështetjen e Merkel për kryesimin e OSBE

Negociatat, ministri gjerman në Tiranë: Integrimi s'është fjalë, vijoni reformat

Heiko Maas: Qershori 2019, jo automatizim i çeljes së bisedimeve

Darina Tanushi

Kryeministri Edi Rama kërkoj dje, mbështetjen e Gjermanisë në mënyrë që Shqipëria të marrë kryesimin e OSBE-së. Këtë kërkesë Rama ia bëri ministrit të Jashtëm gjerman Heiko Maas, i cili erdhi për një vizitë në Tiranë. Nga ana e tij, ministri gjerman bëri të qartë se caktimi i qershorit 2019 nuk është një vendim që nënkupton hapjen automatike të negociatave, ndaj duhet vijuar me reformat dhe jo me fjalë. "Ne jemi shumë mirënjohës qeverisë federale, Kancelares për rolin e rëndësishëm, në funksion të mbështetjes së një prej reformave më themelore shtetbërëse të Shqipërisë europiane, reformës në drejtësi, si dhe padyshim të gjitha reformave të tjera që lidhen drejtpërdrejt me progresin në funksion të integritimit në Bashkimin Evropian", -u shpreh Rama. "Unë do të përsëris një kërkesë që me e kemi bërë, për të marrë mbështetjen e qeverisë federale për kandidaturën e Shqipërisë për të drejtuar OSBE-në. Jemi të bindur që kjo do të kontribuonte edhe në funksion të vetë dinamikeve të rajonit tonë, të procesit integruar të rajonit dhe do të ishte një incentive për Shqipërinë dhe për rajonin", -u shpreh Rama. Nga ana e tij, ministri Maas, duke iu drejtuar kryeministrit Rama i tha: "Mënyra kurajoze për të bërë politikë është demonstruar tashmë e suksesshme. Fakti që janë nisur reforma të thella, sikurse është ajo e drejtësisë, e kudo njohur dhe gjithëseskush këtu, në rajon, apo në Berlin, apo në BE, e dinë se sa e rëndësishme është kjo reformë për perspektivën evropiane të Shqipërisë, ndaj është mjaft e rëndësishme që qeveria të mund të vijojë më tej, në rrugën e nisur tanimë. Ju jeni një vend që mund të konsideroheni si spirancë e stabilitetit dhe qëndrueshmërisë në rajon.

Në qershor, Bashkimi Evropian vendosi që prej vitit 2019 mund të nisnin bisedat për anëtarësimin me Bashkimin Evropian, por për këtë duhet që të vijonin



Kryeministri Edi Rama dhe ministri i Jashtëm gjerman Heiko Maas, dje në Tiranë

më tej edhe proceset e reformave. Sigurisht që ka kundërshtit, apo të themi rezistencë në këto procese, të cilat do të duhet të kapërceheshin në mënyrë të tillë që të sigurohet perspektiva evropiane dhe të gjithë do të duhej të dinin të përballëshim me këto çështje", -u shpreh ministri gjerman. "Gjithësesi, Shqipëria mund të mbështetet gjithmonë në ndihmën e Gjermanisë. Perspektiva

europiane e Shqipërisë nuk është vetëm fjalë nga ana jonë dhe nëse ju do të vijonit me rrugën tuaj, sikurse kemi parë vitet e fundit, do të përmbushnit kushtet e kërkuara tanimë, atëherë rruga drejt BE do të vijojë, gjithashtu, më tej e për këtë kemi mbështetjen tonë të plotë", -u shpreh Maas. Ministri i Jashtëm gjerman pati një takim më herët me homologun e tij shqiptar, Dit-

mir Bushati e më vonë edhe me kreun e opozitës Lulzim Basha. Gjatë konferencës së përbashkët me ministrin Bushati, Maas tha se vendimi i marrë që cakton si datë qershorin 2019

"është një vendim, i cili tregon, gjithashtu, vlerësim për reformat që janë ndër-marrë në vitet e fundit në Shqipëri dhe mendoj që ka qenë vërtet një angazhim mjaft energjik, politik, tepër kurajoz përmes të cilit shumë çka është realizuar, jo domosdoshmërisht ka qenë e thjeshtë dhe për këtë, Shqipëria mund të jetë mjaft krenare". "Në të njëjtën kohë, shtoi Maas, sikurse e dimë, shtetet anëtare të Bashkimit Evropian kanë bërë, gjithashtu, të qartë që qershori i vitit 2019 nuk do të jetë një automatizim për sa i përket nisjes apo çeljes së bisedimeve të anëtarësim-it. Kriteret për këtë janë të hapura dhe të qarta, të ditura dhe të qarta, pra, duhet të ekzistojnë hapa për rezultate të tjera për sa i përket reformave në mënyrë të tillë që të mund të bindim edhe të gjithë ata që janë disi skeptikë për sa i përket këtij procesi. Bëhet fjalë më së shumti për konsolidimin e shtetit ligjor apo pavarësinë e sistemit të drejtësisë".

Taulant Balla takon presidentin e PES

Sergei Stanishev: PD të jetë konstruktive, të lerë bojkotin

Presidentin i Partive Socialiste Europiane, Sergei Stanishev i sugjeroi opozitës shqiptare të ndalë bojkotin dhe të bëhet bashkëpunuese për çështjet e integritetit të Shqipërisë. Në një takim me kreun e Grupit Parlamentar të PS-së, Taulant Balla, Stanishev u shpreh: "Sigurisht duhet të vazhdohet me reformat shumë serioze që janë ndërmarrë, sepse qeveria e Edi Ramës, mazhoranca në parlament, kanë ndër-marrë reforma të rëndësishme, siç është reforma në drejtësi dhe kam bindjen se procesi i vetingut



po ecën mirë, në mënyrë transparente dhe po rino-von sistemin, duke kthyer besimin tek sistemi, dhe kjo është shumë e rëndësishme". "Dëshiroj t'i drejtohem edhe opozitës, Partisë Demokra-

tike në veçanti, në lidhje me bojkotin e tyre. Anëtarësimi i Shqipërisë në Bashkimin Evropian është një çështje kombëtare, ky anëtarësim i shërben vetëm qeverisë së Edi Ramës, por i shërben qdo shqiptari dhe ka gjëra që duhen bërë, me përplekje të përbashkëta të mazhorancës dhe të opozitës. Ndaj, pres që ata të jenë konstruktiv në këtë aspekt dhe dëshiroj t'i kujtoj që Këshilli Evropian i kërkoj opozitës të lërë bojkotin dhe të mos rrijë jashtë parlamentit, sepse gjithsesi ju duhet një parlament konstruktiv, legjitim dhe funksional", -tha Stanishev.

TERRORIZMI RAPORTI

Departamenti Amerikan publikon raportin vjetor për terrorizmin në botë për 2017-ën

Terrorizmi, DASH për Shqipërinë: Problem korrupsioni e gjyqësori

“S”ka bashkëpunim mes agjencive”

Departamenti Amerikan i Shtetit publikoi dje raportin vjetor për terrorizmin në botë për vitin 2017. Në raport thuhet se gjatë vitit 2017, Shqipëria ishte një mbështetëse e fuqishme e përpjekjeve kundër terrorizmit dhe vazhdoi pjesëmarrjen e saj në Aleancën Globale për të Mposhtur ISIS-in. Shqipëria, thuhet në raport, penalizon veprimet terroriste, financimin e terrorizmit, kryerjen e transaksioneve me persona që janë në listat e sanksioneve të Kombeve të Bashkuara, rekrutimin dhe trajnimin e njerëzve për kryerjen e veprave terroriste, nxitjen e akteve terroriste dhe krijimin apo pjesëmarrjen në organizata terroriste. Gjatë vitit 2017 - thuhet në raport - forcat e rendit në Shqipëri i shtuan përpjekjet për të luftuar kërcënimet e mundshme terroriste. Korrupsioni dhe pengesat ndaj shkëmbimit të informacionit midis agjencive qeveritare, koordinimi i pamjaftueshëm brenda agjencive dhe një sistem gjyqësor që funksionon dobët - thotë raporti - vazhdoi të pengonte përpjekjet e zbatimit të ligjit në të gjitha nivelet. Në raport thuhet gjithashtu se në vend po bëhen reforma kushtetuese dhe ligjore për gjyqësorin, duke filluar me verifikimin e 800 gjyqtarëve dhe prokurorëve për korrupsion apo lidhje me krimin e organizuar si dhe për aftësitë e tyre profesionale. Sipas raportit, Kosova vazhdoi t'i kundërvihet kërcënimit gjithnjë në rritje të terrorizmit në vitin 2017. Rreth 403 qytetarë të Kosovës - thotë raporti - kanë udhëtuar në Siri dhe Irak për t'u bashkuar me ISIS-in apo Frontin el-Nusrah, prej të cilëve rreth 74 kanë vdekur. Rreth 133 prej këtyre individëve janë kthyer, ndërsa rreth 196 mbeten në këto zona konfliktit. Ky numër përfshin 40 fëmijë të lindur nga qytetarë të Kosovës në zonat e konfliktit. Gjendja e sigurisë dhe ajo politike në veriun e Kosovës - thuhet në raport - ka vazhduar të kufi-



Foto ilustruese

zojë aftësinë e qeverisë për të ushtruar autoritetin e saj në atë rajon, megjithëse qeveria ka integruar me sukses gjyqtarët, prokurorët dhe stafin serb

në institucionet gjyqësore të Kosovës në tetor, duke zgjeruar autoritetin gjyqësor të vendit dhe qasjen në drejtësi për qytetarët. Legjislacioni, zbatimi i ligjit

dhe siguria kufitare: Kuadri ligjor i Kosovës është i mjaftueshëm për të ndjekur penalisht individë të dyshuar për kryerjen ose mbështetjen e aktiviteteve terror-

RAPORTI

Sipas raportit, Shqipëria penalizon veprimet terroriste, financimin e terrorizmit, kryerjen e transaksioneve me persona që janë në listat e sanksioneve të Kombeve të Bashkuara, rekrutimin dhe trajnimin e njerëzve për kryerjen e veprave terroriste, nxitjen e akteve terroriste dhe krijimin apo pjesëmarrjen në organizata terroriste.



iste, por prokurorët nuk kanë përvojë në raste të tilla - thuhet në raport. Autoritetet e zbatimit të ligjit treguan aftësi të mjaftueshme për të zbuluar dhe parandaluar individë të ndryshëm që t'u bashkoheshin konflikteve në Siri dhe Irak. Sipas raportit, në Kosovë vazhduan gjykimet dhe hetimet për 51 të dyshuar dhe 29 raste, ku përfshiheshin disa imamë të arrestuar që nga viti 2014 nën

akuza për terrorizëm. Në vitin 2017, autoritetet e Kosovës arrestuan pesë individë të tjerë nën të njëjtat akuzat. Autoritetet ngritën shtatë akt padi të reja me akuzë për terrorizëm që përfshinin 17 individë. Gjatë vitit 2017 - thuhet në raport - qeveria e Kosovës ndërmoi hapa aktivë për të përgatitur një strategji riadhesimi për qytetarët e saj që ktheheshin nga zonat e konfliktit.

Sfidat e integritetit evropian, PD zhvillon bashkëbisedim me përfaqësuesit e PPE

Doris Pack, porosi politikanëve: Ndërtoni shkolla, jo kulla!

Partitë Popullore Evropiane apelojnë për motivim të të rinjve shqiptarë, me qëllim që të ndërtojnë të ardhmen e tyre në Shqipëri dhe jo ta braktisin atë në kërkim të një jete më të mirë. Partia Demokratike priti dje në një diskutim të hapur në selinë e saj, përfaqësuesen e PPE-së Doris Pack, e cila deklaroi se politikanët duhet t'i motivojnë të rinjtë që mos të largohen nga vendi. Gjatë bashkëbisedimit në selinë e demokratëve, Pack bëri një apel të fortë, ku theksoi se Tirana në krahasim me 5 vitet e mëparshme nuk ka nevojë për shumë kulla, por vendin e tyre duhet ta zënë shkollat e reja. "Jam e nderuar që jam këtu dhe e shikoj sallën plot. Jam e kënaqur që shikoj shumë të rinj këtu që kanë vendosur të mos largohen nga ky vend. Ky nuk është një problem vetëm i Shqipërisë, por i Kosovës,



Serbisë, Maqedonisë dhe Kroacisë. Kjo ndodh se politikanët nuk po kujdesen për nevojat jetësore të tyre. Faktikisht nuk e mbaj mend se herë kam ardhur në Shqipëri, por këtu nuk ka nevojë për shumë kulla, por për më shumë shkolla. Normalisht ka nevojë për investime, të cilat do të bëhen nëse sistemi i drejtësisë vihet në vend. Unë jam presidente e forumit të gruas, por drejtohet edhe forumin që trajnon të rinjtë", tha Doris Pack. Deklarata u bë nga selia e PD-së gjatë një bashkëbisedimi me temë "Sfidat e integritetit eu-

ropian-ropi i të rinjve dhe i grave në procesin e hapjes së negociatave", ku presidentja e Forumit të Grave të PPE ishte e ftuar. Doris Pack deklaroi më tej: "Ne duam të zhvillojmë krijimtari brenda këtyre politikave që politikanët të bëjnë më të mirën. Këtu ka nevojë për shkolla të mira, arsimim më të mirë, ndaj BE mendoj të shtrinte mundësinë përtej BE. Këto programe nuk janë vetëm për studentët, por edhe për mësuesit dhe diplomatët", theksoi diplomatja evropiane. Ndërkohë, deputetja e PD-së, Albana Vokshi shprehu shqetësimin se aktualisht në të gjithë vendin janë mbyllur 180 shkolla dhe kjo sipas saj tregon gjendjen e rëndë ku është katandisur kjo qeveri. "Sot numërojmë 180 shkolla të mbyllura. Ju e dini shprehjen se një shkollë e mbyllur do të thotë një burg i hapur. Ku po shkojmë me mbylljen e shkollave", deklaroi deputetja e PD-së.



PD padit Veliajn: Dha 2.6 milionë euro për blerjen e 400 pishave

Pd bëri dje kallëzim penal ndaj kryebashkiakut të Tiranës, Erion Veliaj. Akuzat konsistojnë në shpërdorim detyre dhe shkelje të barazisë së tendera. Sipas deputetit demokrat, Klevis Balliu, i cili ka paraqitur edhe padinë në prokurori, Veliaj ka shkelur ligjin duke i dhënë 2.6 milionë euro për blerjen e 400 pishave kompanisë "Fusha". "Erion Veliaj ka shkelur ligjin në mënyrë flagrante për t'i dhënë miliona euro të tjera kompanisë "Fusha", të njëjtës kompani që zgjodhën për të vjedhur tek sheshi "Skënderbej", të njëjtës kompani që po përdorin për të grabitur tokën e Teatrit Kombëtar për të ndërtaur kullat me paratë e drogës dhe korrupsionit. Ai i ka dhënë kompanisë "Fusha", 2.6 milionë euro për blerjen e 400 pishave. Ligji përcakton garë transparente, por kur bëhet fjalë për "Fushën", për Malin e Bashkisë së Tiranës ligji shkelet dhe gara eliminohet", deklaroi z.Balliu. Deputeti njoftoi se kryebashkiaku ka pranuar që një pjesë të blihet me një vlerë prej 6.500 euro copa. Balliu tha se ka paraqitur në Prokurori prova filmike dhe disa fotografi që tregojnë prerjen dhe tharjen e pishave, njësoj si palmat. Sipas Partisë Demokratike, pronari i kompanisë "Fusha", Shkëlqim Fusha është familjar i afërt me Petrit Fushën, që drejtohet Prokurorinë e Tiranës dhe mbylli dosjen e Ardrit Gjoklajt, ku bashkia kishte përgjegjësi penale.

Autorët i zunë pritë afër shtëpisë, Andrea Zoga: Është hera e dytë që më kërcënojnë

Ina Allkanjari

Dhunohehet nga bandat biznesmeni: Nëse prokuroria s'heton, do largohem nga Shqipëria

"Po paguaj për borxhet e vëllait, është në konflikt për arsye prone"

Biznesmeni Andrea Zoga, i njohur në Tiranë në fushën e restoranteve dhe "fast food"-eve ka mbetur i lënduar mesnatën e së martës, pasi persona ende të pidentifikuar e kanë dhunuar. Ngjarja në fjalë ka ndodhur në Rrugën "Merdar Shtylla" në "Komunën e Parisit", teksa Zoga po shkente në banesën e tij. Në një intervistë për "Gazeta Shqiptare", biznesmeni tregon se shkak i ngjarjes dyshon se është një konflikt që vëllai i tij ka me disa persona të tjerë për çështje pronësie. Por Zogaj thekson se vetë nuk kishte konflikt me askënd dhe marrëdhëniet me të vëllain i ka shkëputur prej një viti. Përsa i përket ngjarjes, biznesmeni theksoi se 4-5 persona i kishin zënë pritë pranë banesës. Ai tregon se nuk ka mundur t'i identifikojë, por personat në fjalë kanë lëvizur me një makinë tip "Golf". Gjithashtu, Zoga rrëfen se nuk është hera e parë që kërcënohet, pasi një vit më parë është kanosur me jetë brenda në zyrat e tij, në ambientin e punës, ngjarje të cilën e lidh me dhunën fizike që ushtruan ndaj tij mesnatën e së martës. Për biznesmenin besimi te drejtësia është shuar, pasi sipas tij çështja e kërcënimit të ndodhur një vit më parë nuk u zgjidh me arsyetimin se ka mungesë provash. Së fundmi Andrea Zoga, i cili aktualisht ndodhet në spitalin e traumës, i



Biznesmeni Andrea Zoga, dje në spitalin e Traumës

bën apel shtetit që të hetojë për këta persona që mendon se janë pjesë e një bande dhe t'i vendosë përpara drejtësisë, përndryshe e vetmja rrugëdalje që sheh është largimi nga Shqipëria.

Çfarë ndodhi mesnatën e së martës, mundët t'i identifikoni personat që ju dhunuan?

Isha fare pranë banesës ku jetoj në zonën e "Komunës së Parisit". Dallova dy persona me kapele që po drejtoheshin drejt meje. Kishin ulur kokën që të mos i njihja. Menjëherë sapo kuptova që diçka nuk shkonte, 4 persona mu sulën dhe më dhunuan fizikisht. Nuk munda t'i identifikoj. Nuk patëm asnjë komunikim. Shkova në

Dhunimi i biznesmenit, Berisha: Ngrihuni kundër qeverisë!

Ish-kryeministri Sali Berisha reagoi dje pas ngjarjes së rëndë, që ndodhi gjatë natës në zonën e "Komunës së Parisit", ku një biznesmen ra pre e dhunës barbare nga disa persona ende të pidentifikuar. Berisha shprehet në "Facebook" se kjo është klima e biznesit në qeverinë "Rama". Teksa dënoi ngjarjen në fjalë, Berisha ftoi bizneset që të ngrihen kundër qeverisë. "Kjo është klima e biznesit në narkoshtetin e Noriegës! Duke dënuar me ashpërsinë më të madhe këtë akt kriminal të përsëritur të bandave të qeverisë, i uroj biznesmenit shërim të plotë dhe të shpejtë. Unë gjithashtu ftoj mbarë biznesmenët e vendit të mos presin radhën për të pësuar fatin e kolegut të tyre, por të ngrihen fuqishëm kundër narko-qeverisë së bandave dhe të kimit!", shprehet z.Berisha.

polici dhe bëra denoncim, por nuk kam besim që do jepet zgjidhje.

Cili është shkak i ngjarjes, në çfarë konfliktesh është përfshirë vëllai juaj?

Së pari, unë jam biznesmen në tregun shqiptar prej 20 vitesh tashmë. Nuk kam konflikt me askënd. Im vëllai ndodhet në konflikt me disa persona për arsye prone, pasi

mbi këtë pronë është ndërtuar një pallat dhe vëllai ka detyrim ndaj këtyre personave. Unë kam mbi një vit që nuk kam marrëdhënie me vëllain, ai është jashtë shtetit. Pavarësisht kësaj, nuk është hera parë që kërcënohem. Më herët më kanë kërcënuar me jetë brenda në zyrat në ambientin e punës persona që nuk i njihja. Më

thamë që do sqarosh problemin e vëllait tënd, në qoftë se ai nuk ndodhet në Shqipëri, do e sqarosh ti. U thashë që nuk flas me tim vëlla prej vitesh, nuk kam lidhje me këtë histori, ju lutem më lini rehat. Çështjen e kam çuar në prokurori që nuk jam në dijeni dhe përgjegjësi për këtë çështje.

Pas hetimit mbi kërcënimin e ndodhur rreth një vit më parë, u identifikuan personat që ju kanosën?

Prokurori Julian Zonja e mbylli këtë çështje pa e rihapur fare, pasi nuk gjen prova. Nuk kam asnjë informacion dhe nuk e di se kush janë personat në fjalë. Shteti të hetojë. Pasi është mbyllur çështja, një bandë më dhunon në mes të rrugës. Kjo është drejtësia që po marr. Prisin të dhunoheshin që çështja të merrej seriozisht!

Cili është apeli juaj?

Kërkoj drejtësi, shteti të kapë bandat. Të hetohet, të identifikohen dhe kapen autorët, përndryshe e vetmja zgjidhje është të largohem nga Shqipëria.

Rrëzohet kërkesa e Klevis Likës për ndryshimin e masës së sigurisë

Eurot në "Toyota", prokuroria: Ekspertim për itinerarin e kamionit

TIRANË - Në kuadër të hetimeve për sekuestrimin e 3.4 milionë eurove pak kohë më parë në portin e Durrësit, Prokuroria për Krime të Rënda ka ngarkuar një ekspert të sigurisë rrugore të verifikojë itinerarin e lëvizjeve të kamionit, me të cilin u transportuan makinat "Toyota Yaris", ku ishin fshehur paratë. Një ekspert i sigurisë rrugore është ngarkuar nga Prokuroria për Krime të Rënda të verifikojë itinerarin e lëvizjeve të kamionit, me të cilin u transportuan makinat "Toyota Yaris", ku ishin fshehur 3.4 milionë euro, që u sekuestruan në portin e Durrësit. Në vendimin për kryerjen e ekspertimit teknik, prokuroria ka kërkuar që të përcaktohet se kush rezultoi të ketë qenë drejtues i karrocit "Bizar", nga data e nisjes më 13 qershor 2018 deri në datën e kthimit 24 qershor 2018. Prokuroria gjithashtu kërkon të dijë me saktësi rrugën e ndjekur nga mjeti në fjalë, orët e punës, të pushimit, shpejtësinë e lëvizjes, vendet e nisjes dhe të mbërritjes.

HETIMET

Në vendimin për kryerjen e ekspertimit teknik, prokuroria ka kërkuar që të përcaktohet se kush rezultoi të ketë qenë drejtues i karrocit "Bizar", nga data e nisjes më 13 qershor 2018 deri në datën e kthimit 24 qershor 2018. Prokuroria gjithashtu kërkon të dijë me saktësi rrugën e ndjekur nga mjeti në fjalë, orët e punës, të pushimit, shpejtësinë e lëvizjes, vendet e nisjes dhe të mbërritjes.

tualisht nën arrest, rezultoi të ketë udhëtar në rrugë tokësore nga Shqipëria drejt Belgjikës. Mendohet se në shtetin belg janë ngarkuar në karrocet automatjetet dhe prej andej, ato udhëtar në drejtim të Gjermanisë, Italisë dhe përmes portit të Barit mbërritën në Durrës. Në fakt, referuar dokumentacionit rezultoi se



karrocet që transportonte ngarkesën do të hynte në Shqipëri nga Porti i Ankonas dhe vijon të mbetet e paqartë përse u ndryshua itinerari i lëvizjes. Ndërsa prokuroria vijon hetimet lidhur me ngjarjen, nga ana tjetër gjykata për Krimet e Rënda rrëzoi ditën e djeshme kërkesën për ndryshim masë bërë nga Klevis Lika. I ri kërkoi lirimin nga burgu me qëllim që t'i jepej mundësia për të përfunduar shkollën e mesme. Por prokuroria kërkoi rëzimin e kërkesës së bërë nga pala mbrojtëse e adoleshentit me pretendimin se duhet të vijnjë letërporsitë nga Anglia, Belgjika dhe Italia, përmes të cilave kërkon informacion për kushërinjtë Elvis e Alfred Vladi, të shpallur në kërkim si organizatorë. Sipas prokurorit të çështjes, lirimi i të riut do cenonte procesin e hetimeve.

Plagosje në Tiranë, babai i nguli thikën të dashurit të vajzës

Një konflikt mes dy personave ka degraduar në përdorimin e armëve të ftohta, duke mbetur i plagosur një 40-vjeçar. Ngjarja ka ndodhur në një lokal në zonën e "Unazës së Re" në Tiranë. Rezmir Çaushaj, 51 vjeç, ka plagosur me thikë një 40-vjeçar, pasi ishte kundër lidhjes që kishte vajza e tij me këtë të fundit. 51-vjeçari ka tentuar disa herë t'i ndajë, por kur nuk ia ka arritur qëllimin. Ai ka ftuar të dashurin e vajzës në një lokal dhe më pas i ka ngulur thikën duke e lënë të plagosur. "Plagos me mjet prerës 40-vjeçarin pas një konflikti për motive të dobëta. Policia kap dhe shoqëron autorin. Nga shërbimet e Policisë të Komisarariatit Nr.6, u bë kapja dhe shoqërimi i shtetasit R. C. Ky shtetas ditën e sotme rreth orës 10:15, në zonën e "Unazës së Re" pas një konflikti, ka plagosur me mjet prerës një shtetas të moshës rreth 40 vjeç, i cili aktualisht ndodhet në spital, nën kujdesin e mjekëve", thuhet në njoftimin e policisë.

SHPALLJE ANKANDI
Date 24.09.2018, Ora 16:00
Shoqëria Përmbarimore "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë rr. "George W. Bush", Pallati "Kasmi", Zyra 107, Tiranë. Tel. 404506426, Cel. 067 201 9460/ 068 904 9202, e-mail: besnik.bajraktari@gmail.com. Shpall ankandin e trette për pasurinë e paluajtshme të dëbtorit Enkoleta Shaban Novaku dhe dorëzansit Adrialik Sofër Novaku:
- "Truall" me sipërfaqe 100 m² dhe "Ndertesa me 3 kate me sipërfaqe 90 m² secili, nr. i pasurisë 4706, zona kadastrale 0581, vol. 12, fage 09, adresa: Luga Nr. 1, Pogrosje.
Çmimi fillestar i ankandit të trette është në shumën 6 552 000 (gjashtë milionë e pesëqindë e postshdijë e dy mijë) lekë.
Ankandi do të zhvillohet në ambientet e Shoqërisë Përmbarimore "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë: Rr. "George W. Bush", Pall. Kasmi, Zyra 107, Tiranë.

SHPALLJE ANKANDI
Date 24.09.2018, Ora 16:45
Shoqëria Përmbarimore "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë rr. "George W. Bush", Pallati "Kasmi", Zyra 107, Tiranë. Tel. 404506426, Cel. 067 201 9460/ 068 904 9202, e-mail: besnik.bajraktari@gmail.com.
Shpall ankandin e parë për pasurinë e paluajtshme të dëbtorit Enkoleta Shaban Novaku dhe dorëzansit Adrialik Sofër Novaku:
- "Truall" me sipërfaqe 100 m² dhe "Ndertesa me 3 kate me sipërfaqe 90 m² secili, nr. i pasurisë 4706, zona kadastrale 0581, vol. 12, fage 09, adresa: Luga Nr. 1, Pogrosje.
Çmimi fillestar i ankandit të parë është në shumën 1 440 000 (një milion e katërqind e dyzet mijë) lekë.
Ankandi do të zhvillohet në ambientet e Shoqërisë Përmbarimore "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë: Rr. "George W. Bush", Pall. Kasmi, Zyra 107, Tiranë.

Gjykata e Shkallës së Parë e dënoi me 5 vjet burg për abuzim me tenderët e ushqimeve në burgje

U akuzua për korrupsion, Apeli shpall të pafajshëm ish-drejtorin e Burgjeve

Ardian Leka: Procesi ndaj Artur Zotos një mashtrim i Iliaz Labit

Ish-drejtori i Burgjeve, Artur Zoto ka lënë pas diten e djeshme qelinë e burgut në Vaqarr pasi Gjykata e Apelit e Krimeve të Rënda e shpalli të pafajshëm në lidhje me akuzën për korrupsion dhe abuzim me tenderët e ushqimeve në burgje. Vendimi i dhënë ka shfuqizuar dënimin e dhënë më 11 maj 2018 nga trupa gjyqesore kryesuar nga Bib Ndreca. I ulur në sediljen e pasme të automjetit, Zoto nuk ka preferuar të japë asnjë koment për mediat. Ish-drejtori i burgjeve fitoi pafajësinë pasi qëndroi më shumë se një vit në paraburgim. Ai akuzohej për abuzime me tenderët e ushqimeve në burgje, por në bazë të provave të reja Gjykata e Apelit të Krimeve të Rënda e ka shpallur atë të pafajshëm. Ky vendim ishte i pritshëm për avokatin e tij Ardian Leka, i cili besonte në pafajësinë e Zotos. Leka e quan procesin ndaj klientit të tij si një mashtrim të të penduarit të drejtësisë Iliaz Labi. "Organi i prokurorisë i ka paraqitur gjykatës një sërë provash, ndërkohe që të gjitha provat që i paraqiti gjykatës bien ndesh me të gjithë deklaratimet e Iliaz Labit. Ky i fundit tregonte që ka pasur marrëdhënie me Artur Zoton, ndërkohe që nuk ka pasur Labi thoshte se ka kryer afere korruptive në zyrën e klientit tim, ndërkohe që kjo nuk ka ndodhur, janë verifikuar pamjet filmike. Thoshte që ka komunikuar disa herë në telefon me Artur Zoton, ndërkohe që nuk ka folur asnjëherë, nuk ka asnjë kontakt, madje as numrat nuk janë në telefonat e njëritjetrit. Gjykata e Apelit mori për bazë të gjithë provat, siç ishin kamerat, kontaktet telefonike, në vlerësimin total të të gjitha provave u dha edhe vendimi. Vendimi i Apelit ishte i pritshëm, pasi klienti



Ish-drejtori i Burgjeve, Artur Zoto



Ardian Leka, avokati i Artur Zotos

VENDIMI

Ish-drejtori i burgjeve Artur Zoto fitoi pafajësinë ditën e djeshme pasi qëndroi më shumë se një vit në paraburgim. Ai akuzohej për abuzime me tenderët e ushqimeve në burgje, por në bazë të provave të reja Gjykata e Apelit të Krimeve të Rënda e ka shpallur atë të pafajshëm. Ky vendim ishte i pritshëm për avokatin e tij Ardian Leka, i cili besonte në pafajësinë e Zotos.

im është pafajshëm", u shpreh avokati i Artur Zotos, Ardian Leka. Prokuroria mori për bazë akuzat e ish-vartësit të Zotos, Iliaz Labit, i cili akuzonte Zoton për korrupsion me tenderët e ushqimeve të të burgosurve. Iliaz Labi i akuzuar për përfshirje në këtë skemë, është dënuar me 3 vite burg nga Krimet e Rënda. "Me

kërkesë të Prokurorisë për Krime të Rënda, gjykata ka vendosur masën e sigurisë "arrest me burg" për ish-drejtorin e Përgjithshëm të Burgjeve, Artur Zoto, i dyshuar për "korrupsion pasiv", në kuadër të hetimit të nisur pak kohë më parë, ku u arrestua edhe ish-zëvendësi i tij, Iliaz Labi. Ur-

nga qelia dhe për plot 6 herë kërkesa e tij për lirim u refuzua. Ishte dëshmia e vartësit të tij Iliaz Labi ish numri dy i burgjeve që dërgoi në arrestimin e Zotos dhe të disa biznesmenëve të dyshuar për korrupsion. Labi deklaroi para prokurores Elisabeta Imeraj se ai kishte marrë 2 milionë lekë nga tre firma konkurruese duke i ndarë paratë me eprorin e tij Artur Zoto. Një seri bisedash të përgjuara nga Prokuroria e Krimeve të Rënda, kanë ngritur dyshime të forta për implikimin në aferat korruptive në tenderët e ushqimit në burgje, dhe të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve Artur Zoto. Në dosjen hetimore, ndodhen dhjetëra procesverbale me biseda të transkriptuara, të cilat tregojnë se drejtori Zoto, tashmë i dorëhequr ka qenë në dijeni të këtyre aferave korruptive, dhe se Iliaz Labi nuk bënte asnjë hap, pa miratimin e Zotos. Ndaj këtij të fundit prokuroria nuk lëshoi asnjë urdhër-arrest. Por dy ditë pas operacionit të arrestimit të zëvendësimit të tij Iliaz Labi dhe katër biznesmenëve Elidjan Laskaj, Ylber Kalaja, Shemsi Sinani e Nexhmi Balla, Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve ka dhënë dorëheqjen, duke ia justifikuar largimin ministrit të Drejtësisë Manjani nëpërmjet një letre, ku i shkronte se ishin motivet personale dhe familjare të tij, që e çonin në largimin nga kjo detyrë.



Sekuestrohen 1.2 mln euro, dyshime se do përdoren në aktivitet kriminal

TIRANË- 1.2 milionë euro janë sekuestruar në një bankë të nivelit të dytë. Nga dyshimet e para mësohet se shuma e bllokuar do të përdoret për aktivitet kriminal. Paratë janë sekuestruar për llogari të shtetasit A.H. Nga hetimet e kryera mësohet se transaksionet bankare nuk përputhen me të dhënat e shoqërisë. Nga aktet paraprake në dispozicion të prokurorisë transaksionet bankare në lidhje me këtë shumë janë justifikuar me anë të kontratave të dyshimta që nuk përputhen me të dhënat e shoqërisë akcionet e të cilës janë shitur në shumën 1.2 milionë euro. Hetimet paraprake hedhin dyshime të forta se kjo shumë eurosh, në bashkëpunim edhe me palët e treta do të shkonte për veprime kriminale. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, pas referimit të Drejtërisë Vendore të Policisë Tiranë, ka bllokuar shumën e eurove, të cilat pretendohet se ishin justifikuar nga kontrata të dyshimta.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: **"Blerje e një pajisje pirun elektrik për nevojat e Bankës së Shqipërisë"**

'Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 1,996,800 Lekë**".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Hallili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411 (ext. 4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e pakthyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: **"Blerje e një pajisje pirun elektrik për nevojat e Bankës së Shqipërisë"**

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më **datë 15 Tetor 2018, ora 14:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

United Nations Development Programme



VACANCY ANNOUNCEMENT

The UNDP office in Albania is looking for a qualified candidate who could fill the following consultancy vacancy.

Job ID: 0264
Post Title: Quality Assurance Local Expert
Duty station: Tirana, Albania
Duration of Assignment: Sixty days (60), over a four-month period
Type of Contract: Individual Contract (IC), opened only for national experts
Educational Background: G-Bachelor's Level Degree – 5 year(s) experience

Work Experience:

At least five (5) years of professional experience, that includes engagement in quality management; Sound knowledge and experience in compliance and monitoring in public or private sector. Experience in analytical studies is preferred. Experience with customer service is preferred.

Deadline for Application: 30/09/2018 (Midnight New York, USA)
Job Description: Available at UNDP site:

https://jobs.undp.org/cj_view_job.cfm?cur_job_id=80264.

Interested and qualified candidates are requested to submit their application online only (available at <http://www.al.undp.org/content/albania/en/home/operations/jobs/>). Incomplete applications will not be considered. Only short-listed candidates will be notified.

United Nations Development Programme % Rr. "Skenderbej", Gurten Building, Tirana, Albania
Tel: +355 4 2400 721 Fax: +355 4 2400 725/6 % Email: registry.al@undp.org Web: www.undp.org/al

Përditësohet regjistri i pronarëve që presin kompensim nga viti 1993 deri në vitin 2014

Ornela Manjani

ATP publikon listën me 8000 dosjet dhe vendimet gjyqësore

Vendimet e formës së prerë dhe problematika për çdo rast

Agjencia e Trajtitimit të Pronave publikon listën me 8 mijë vendime, të cilat ose kanë marrë një vendim të formës së prerë nga gjykata, ose kanë problematika me dosjen. Regjistri i përditësuar për herë të fundit në 10 shtator të këtij viti pasqyron vendimet për çdo dosje. "Në zbatim të pikës 4, nenit 30 të ligjit 133/2015, përditësojmë vendimet gjyqësore në regjistrin përkatës të vendimmarrjes për kthimin/kompensimin e pronave", - thuhet në njoftimin e Agjencisë së Trajtitimit të Pronave. Në pikën 4 të nenit 30 të ligjit të pronave thuhet: "Çdo vendim gjykatë, që ka ndryshuar vendimin e ATP-së për kthimin/kompensimin apo për vlerën e komp-

ensimit do t'i njoftohet ATP-së dhe do të regjistrohet në regjistrin përkatës të vendimmarrjes, i cili mbahet nga ATP-ja. Ky regjistër bashkërendohet me regjistrin aktual të vendimmarrjes së ATP-së dhe të agjencive të tjera të mëparshme kompetente për kthimin dhe kompensimin e pronës". "Gazeta Shqiptare" pub-

likon listën e 8 mijë pronarëve, ku përveç gjeneraliteve është edhe sipërfaqja për çdo pronë, vendimi i gjykatës për rastet kur është marrë vendimi dhe problematika për rastet që kanë mangësi apo pasaktësi në dosje. **REGJISTRIMI I VENDIMIT**
Sipas ligjit në fuqi, kur vendimi i marrë bëhet për-

fundimtar, Agjencia ose çdo palë e interesuar, e dërgon atë në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për regjistrim. "Për vendimet që nuk u është dhënë formë e prerë, për shkak të ndryshimeve të ligjit, Agjencia verifikon nëse është bërë ankim brenda afatit ligjor dhe në rast të kundërt, këto vendime konsiderohen të

formës e prerë. Vendimet mbi të drejtën e parablerjes, që janë verifikuar nga Agjencia pas përfundimit të regjistrimit, do t'i dërgohen Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme brenda një muaji nga data e verifikimit dhe në çdo rast, brenda 18 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Zyra do t'i regjistrojë ato pa aplikuar

gjoba, kamata apo tarifa. Subjektet e interesuara janë përgjegjëse për dorëzimin e dokumentacionit të nevojshëm që kërkohet nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për të mbështetur regjistrimin e vendimit. E njëjta gjë do të bëhet edhe për vendimet e kompensimit", - thuhet në ligj.

DOSET ME VENDIME GJYQËSORE

Emri Mbiemri (Subjekti i shpronësuar)	Emri Mbiemri (Subjekti Kërkuar)	Sip e pretenduar, lloji i pasurisë	Sipërfaqja e Njohur	Vendim Gjykatë	Problematika
MASAR MEMA	LELA MEMA	PRONË, OBORR 302 M2	32 DY	28.08.2004 REEZIM	
ISMAIL AGOLLI	HIKMET AGOLLI	1 SHTEPI	6740 M2		BASHKELIDHUR HARTEN
ISMAIL DIBRA		32 DY			BASHKELIDHUR HARTEN
ZENEL SAJA	RAMIZ SAJA	362 M2	362 M2		
BEQIR KOCQANI	ZIJA KURUGJANI	1 SHTEPI	1 SHTEPI		
SHEKIJM CACO	MEHMET CACO	1 SHTEPI	305 M2		
ISLAM CACO	MEHMET CACO	505 M2	505 M2		BASHKELIDHUR HARTEN
INSTITUTI EUROPIAN PASHKO është një organizatë jofitimprurëse themeluar nga EEI / Iniciativa Europiane për Edukim, si agregim i më shumë se 10 viteve veprimtari në mbështetje të: lirisë ekonomike, inovacionit, lirisë së shtypit, botimeve dhe de batit të ideve, kreativitetit dhe të trashëgimisë kulturore. IEP udhëhiqet nga vlerat e aksionit afirmativ, europianizimit të shoqërisë shqiptare, reformizmit, liberalizimit ekonomik dhe politik, për nder të ideve të profesor Gramoz Pashko, emrin e të cilit mban ky institut, falë dashamirisë së familjes Pashko. / GRAMOZ PASHKO, profesor, ekonomist liberal, figurë sui generis intelektuale, një nga liderët e lëvizjes demokratike të "Dhjetorit 1990" dhe themeluesi i universitetit të parë privat në Shqipëri në vitin 2002. /IEP do të promovojë nëpërmjet gjashtë programeve vlerat e demokracisë liberale, ekonomisë së lirë të tregut dhe europianizimit.

DOKUMENTET E KËRKUARA

CV e hollësishme
Diplomë Master Shkencor / PhD / Certifikata të ndryshme

KRITERET

Të ketë përfunduar studimet në Shkenca Politike/ Juridik / Shkenca komunikimi / Menaxhim / Marketing ose në fusha të përafërta. Të ketë afësi shumë të mira komunikimi dhe strategjike për negociim me të tjerët. Kandidati duhet të jetë i aftë të ndërtojë marrëdhënie me palët e interesuara, partnerët e IEP, institucione jo-qeveritare dhe qeveritare, institucionet rregullatore dhe mediat. Gjithashtu duhet të ketë eksperiencë në zhvillimin strategjik dhe zbatimin e modeleve të anëtarësimit dhe kodet e sjelljes, si dhe të ruaj një vlerësim të lartë të rëndësisë së markës dhe objektivave të organizatës që drejton

Kandidatët e interesuar duhet t'i dorëzojnë dokumentet e aplikimit brenda datës
20 Shtator 2018, ora 15.00, në adresën: kebjana.haka@uet.edu.al



PROGRAMET E INSTITUTIT EUROPIAN PASHKO



DO TË JESH PJESË E STAFIT AKADEMIK TË UET? APLIKO TANI!

I UNIVERSITETI EUROPIAN I TIRANËS REKRUTON STAF NË FUSHAT:

1. Shkenca Ekonomike
2. Shkenca Juridike, Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare
3. Shkenca Humane, Edukimi dhe Arte Liberale
4. Shkenca të Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës
5. Shkenca Mjekësore Teknike

II DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E PEDAGOGUT

1. Mësimdhënie në tre ciklet e studimit BA/MA/DR
2. Këshillim i studentëve
3. Angazhimi në veprimtari kërkimore - shkencore
4. Mbështetje për institucionin

III KRITERET E NJË KANDIDATI TË SUKSESSHËM

1. Preferohet që kandidati të ketë përfunduar të paktën një cikël studimesh (BA/MA/DR) në një universitet anglo-sakson.
2. Të jetë i aftë të garantojë cilësinë, efikasitetin dhe ekselencën e zhvillimit të lëndëve që do të japë dhe t'i përgjigjet me fleksibilitet nevojave të universitetit;
3. Të ketë përvojë në mësimdhënie në shkollën e lartë dhe në fushën e kërkimit shkencor të mirëfilltë.

DOKUMENTET E KËRKUARA

- #### IV
- CV e hollësishme e kandidatit në gjuhën shqipe.
 - Letër motivimi në të cilën të shpjegohen qartë interesat profesionale, fushat e ekspertizës dhe lëndët e synuara.
 - Kopje të listës së notave, shoqëruar me diplomën përkatëse të ciklit të parë dhe të dytë. (notë mesatare mbi 9-të).
 - Kopje të dëshmisë së gradës shkencore/ titujve akademikë
 - Për studimet e kryera jashtë Republikës së Shqipërisë, diploma duhet të jetë e njehsuar nga Ministria përgjegjëse për arsimin.

-Aplikimet duhet të dorëzohen me e-mail në: hr@uet.edu.al ose në zyrën e Burimeve Njerëzore deri më 20 Shtator 2018.

-Konkursi zhvillohet në datat 26-27-28 Shtator 2018

Adresa: Bulevardi Gjergj Fishta, Nd. 70, H.1, Tiranë, info@uet.edu.al



FAKULTETI I EKONOMISË BIZNESIT DHE ZHVILLIMIT

FAKULTETI SHKENCAVE JURIDIKE, POLITIKE DHE MARRËDHËNIEVE NDERKOMBËTARE

FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE EDUKIMIT DHE ARTEVE LIBERALE

FAKULTETI I INXHINIERISË INFORMATIKËS DHE ARKITEKTURËS

FAKULTETI I SHKENCAVE MJEKËSORE TEKNIKE

Mallrat i merrnin nga tragetet dhe ua shisnin personave të ndryshëm

DURRËS

Një mjek, punonjës i Autoritetit Portual Durrës si dhe shoferi i ambulancës janë arrestuar nga policia për kontrabandë cigaresh. Specialistët për hetimin e kimit ekonomik dhe financiar në Drejtorinë Vendore të Policisë Durrës në bashkëpunim me prokurorinë e këtij rrethi, pas një hetimi prej rreth 2 muajsh me metoda speciale kanë finalizuar me sukses operacionin e koduar "Cigarettes". Mësohet se specialistët kanë dokumentuar me prova shkencore se disa shtetas, punonjës në Autoritetin Portual Durrës transportonin mallra kontrabandë, të cilët në bashkëpunim me njëri-tjetrin merrnin steka duhani të markave të ndryshme pa pullë fiskale të autoriteteve shqiptare në tragetet që ankoroheshin në këtë port duke i futur në mënyrë kontrabandë me një ambulancë dhe në vijim ua shisnin personave të ndryshëm. Sipas policisë së qytetit bregdetar janë arrestuar në flagrancë shtetasit: Artan Dhima 49 vjeç, banues në Durrës, mjek në Autoritetin Portual Durrës dhe Zamir Çyrbja

Kontrabandë cigaresh me ambulancë, kapet mjeku i Autoritetit Portual Durrës

Operacioni, përfundon në pranga dhe shoferi



41 vjeç, shoferi i ambulancës në Autoritetin Portual Durrës. Ndërkaq, bëhet me dije se gjatë operacionit në fjalë

u sekuestruan në cilësinë e provave materiale: 300 paketa të markave të ndryshme; 1 mjet i llojit ambulancë, tip

"Volsvagen", i cili shërbente për futjen e cigareve kontrabandë në Portin e Durrësit; 1 automjet tip "Ford" që shërbente për transportin e cigareve nga Porti i Durrësit në shpërndarjen e tyre pranë personave të ndryshëm dhe 2 aparate celularë. Nga ana e grupit hetimor vijnë hetimet për identifikimin e personave të tjerë të implikuar në këtë veprimtari kriminale. Materialet i kaluan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës për veprime të mëtejshme për veprat penale: "Kontrabanda me mallra për të cilat paguhet akcizë ose me pezullim të plotë apo të pjesshëm nga detyrimet doganore ose të akcizës", "Tregtimi dhe transportimi i mallrave që janë kontrabandë" dhe "Shpërdorimi i detyrës" kryer në bashkëpunim

Abuzim me detyrën, ndalohen ish-drejtori dhe juristi i spitalit

BERAT - Ish-drejtori i Spitalit të Beratit dhe juristi i këtij institucioni shëndetësor janë ndaluar nga policia, pasi dyshohen se kanë shpërdoruar detyrën dhe kanë falsifikuar dokumentet. Bëhet fjalë për Ildir Frashërin dhe Alfred Lulajn, të cilët dyshohen se kanë blerë antibiotikë në kundërshtim me ligjin. "Në kuadër të një procedimi penal të vitit 2018 janë ndaluar shtetasit Ildir Frashëri, ish-drejtor i Spitalit Rajonal Berat, i dyshuar për veprën penale të "Shpërdorimi i detyrës në bashkëpunim" dhe të "Falsifikimi i dokumenteve i kryer në bashkëpunim". Dhe shtetasit Alfred Lulaj, jurist i Spitalit Rajonal Berat, i dyshuar për veprën penale "Shpërdorimi i detyrës në bashkëpunim" dhe të "Falsifikimi i dokumenteve i kryer në bashkëpunim". Këta shtetas kanë bërë blerje të mallrave mjekësore (antibiotikë) në kundërshtim me ligjin. Me pas për të justifikuar veprimtarinë e paligjshme të tyre kanë futur në dosjet e blerjeve një kërkesë gjoja sikur mjekët e spitalit kërkonin ilaçe. Hetimet vazhdojnë, pasi do të verifikohen të gjitha procedurat në lidhje me mënyrën se si kanë dalë medikamentet mjekësore nga farmacia e Spitalit të Beratit", thuhet në njoftimin zyrtar të policisë.



maiora premunt / gjëra të mëdha na presin

ZGJIDH UET NË RAUNDIN E DYTË 15-20 SHTATOR

DP/DIPLOMË PROFESIONALE/ 2018-2019

Kontabilitet

Menaxhim

Turizëm

I Dizajn i Aplikuar dhe Modë

I Aplikime Informatike

Këtë vit akademik hapen për herë të parë në UET Diplomat Profesionale. Zgjidh një universitet të madh për të hyrë në botën e profesioneve

DP - DIPLOMË PROFESIONALE / BA - BACHELOR / MP - MASTER PROFESIONAL / MSH - MASTER I SHKENCËVE / ME - MASTER EKZEKUTIV / PINT - PROGRAME TË INTEGRUARA / DR - DOKTORATURË

FAKULTETI I EKONOMISË BIZNESIT DHE ZHVILLIMIT

FAKULTETI SHKENCËVE JURIDIKE, POLITIKE DHE MARRËDHËNIEVE NDËRKOMBËTARE

FAKULTETI I SHKENCËVE HUMANË EDUKIMIT DHE ARTEVE LIBERALE

FAKULTETI I INXHINIERISË INFORMATIKËS DHE ARKITEKTURËS

FAKULTETI I SHKENCËVE MJEKËSORE TEKNIKE

VAJZA I BËRI PYETJE PËR NDËRHJRJET, REAGIMI I KLAUDIAS DO JU HABISË

SUMMER


pages

SUPLEMENT I GAZETË SIKRIPITARE

E enjte 20 Shtator 2018



Elita nuk kursehet, ja çmimi marramendës i këpucëve të 'Hirushes'



Lori Hoxha mahnit fansat, zbuloni çfarë nuk di të bëj milionerja

BULEVARDI POLITIK



- Gafa, Sekretari amerikan i Mbrojtjes pritet me fshesë në Maqedoni
- Kate Middleton, një princeshë edhe para se të ishte në familjen mbretërore
- Ministri gjerman feston ditëlindjen në Tiranë, surpriza e homologut Bushati
- Rama zbulon kush fluturoi dje me "Air Albania", në avion edhe ministrja e Shëndetësisë



Stilisti rrëfen mbi angazhimin e tij më të ri dhe tendencat e vjeshtës

JONI PEÇI:

Ju tregoj dashurinë time të përjetshme

"Zoti dhe prindërit nuk të tradhtojnë kurrë"

Stilisti rrëfen mbi angazhimin e tij
më të ri dhe tendencat e vjeshtës

Joni Peçi:

Ju tregoj dashurinë time të përjetshme

"Zoti dhe prindërit nuk të tradhtojnë kurrë"

Egla Xhemali

Njihet për energjinë pozitive që përcjell si dhe për pasionin me të cilën bën atë që do fort, punën e tij. Në një rrëfim ekskluziv për "Summer Pages" të "Gazeta shqiptare" vjen Joni Peçi. Stilisti më i dashur për publikun shqiptar ndan me ne të fshehtat e botës së modës, tendencat e sezonit të vjeshtës, bashkëpunimet e suksesshme me artistët, copëza nga jeta private si dhe projektet e fundit. Të jesh për 20 vite në tregun e modës dhe të mbash fronin e mbretit përgjatë kësaj periudhe, natyrisht nuk ka qenë e lehtë, megjithatë ai nuk ka reshtur së punuari për të sjellë gjëra të bukura dhe për të qenë një hap larg të tjerëve. Joni njihet për stilimet e veçanta që posedojnë ngjyra, forma dhe mbi të gjitha, pjesë të shpirtit të tij. Peçi është i preferuari i artistëve dhe jo vetëm. Bashkëpunimet me ta kanë rezultuar të suksesshme. Stilisti po bën një hap mjaft të madh këto ditë. Për të gjithë ata që duan të vishen ndryshe, Peçi do sjelli për herë të parë në Shqipëri firmën që do ketë emrin e tij me stilimet e veta. Femrave ua ka zbuluar sekretin. Sipas tij, ato thjesht duan të vishen bukur. Më tej, Joni na tregon se ka shumë miq, por më i shtrenjtë nga të gjithë është Zoti dhe prindërit, pasi ata nuk të tradhtojnë kurrë. Së fundmi, ai ndan me ne projektet që ka me spektaklet e famshme dhe thotë se ka për të qenë një vit i ngarkuar. Ne i urojmë suksese të mëtejshme dhe frymëzim për punë sa më të mira.

Tashmë jemi zyrtarisht në periudhën e vjeshtës. Cilat janë trendet për këtë sezon? Si mund të kombinojemi në përditshmëri?

Tani moda ka evoluuar. Vërtetë vijnë sezonet, ndërrojnë stinët dhe kjo është gjë shumë e bukur, pasi stinët sjellin variane të ndryshme jo vetëm në jetën e përditshme të njerëzve, por edhe në kolore dhe në mënyrat e të veshurit. Tashmë moda ka ndryshuar për të gjithë, jo vetëm nga ana e stilistëve. Moda sot është që ti të jesh vetvetja, të kombinoesh lirshëm me gjëra që të përshtaten me karakterin, me formën e trupit, me personalitetin. Nuk ka ngjyra fikse që



janë të diktuar nga ne njerëzit që bëjmë modë, por ne e bëjmë këtë veshje për njerëzit që të jenë vetvetja dhe të vishen ashtu siç mendojnë.

Si një nga stilistët më të famshëm dhe më të kërkuar, a mund të na tregoni diçka për eksperiencat tuaja me VIP-at? A janë të bezdisur? Cilat janë kërkesat e tyre?

Realisht me modesti e them që në 20 vite të karrierës sime profesionale thuajse kam kaluar 99.9% të gjithë personave publikë dhe jo vetëm që janë veshur, kanë kaluar dhe mbajnë markën "Joni Peçi". Nuk do të doja t'i hyja pjesës së cinizmit se si janë apo nuk janë VIP-at, sepse çdo njeri në fund të fundit ka atë karakterin e vet, ka mënyrën e vet të të sjellit, por tashmë kur kanë kaluar shumë vite me këtë profesion, duke kaluar shumë persona artistë që vishen nga unë, është stabilizuar ajo besueshmëria, për faktin që prej vitesh i kam klientë. Injoh dhe e di karakterin e personave që vijnë, ata që më zgjedhin mua dhe që bashkëpunojmë së bashku.

Si ka qenë ju sezon veror për ju? Keni pushuar apo keni qenë i fokusuar te puna?

Ky sezon për mua ka qenë si të gjithë sezonet e tjera. Unë them një gjë që familja, e dashura, jeta ime, gjithçka imja është puna ime. Unë i dedikohem asaj 24 orë, qoftë edhe në detaje apo edhe në gjërat e vogla. Ajo më ka bërë që ëndrrën time ta realizoj sot pas 20 vitesh duke punuar fort. Ky sezon ka qenë shumë i ngarkuar, në veçanti me projektin e ri që unë do lançoj në datën 20, që fillon me dyqanin e parë pas atel-

liesë. Të gjithë njerëzit mund të vijnë pa asnjë lloj problemi si në të gjithë veshje e tjera në mbarë botën. Ata mund të gjejnë veten duke u veshur për çfarëdolloj eventi dhe për të vazhduar deri te përditshmëria e tyre.

Puna me veshjet është sa e bukur, aq edhe e lodhshme. Sa kohë ju marrin stilimet?

Shpeshherë mendoj se lodhja e kësaj pune është miqs me kënaqësinë. Puna e lodhjes është si të shijosh dhe jetosh një ndjenjë të bukur, ndër- sa gjëja që të lodh është ajo ndjesia që ndjen pas orëve të gjata të përkushtimit. Puna është jeta ime. Duke iu dedikuar asaj, lodhja shpeshherë kalon, por duhet të jesh shumë i kujdesshëm nga kjo gjë, sepse duhet të jesh shumë avangard, duhet të paraprish modën, duhet të nuhasësh çfarë kërkojnë dhe duan njerëzit. Unë mendoj që tashmë kanë filluar edhe meshkujt të kurohen dhe një pjesë e mirë të klientëve që kam e zënë ata. Tek femrat e kam gjetur sekretin, sepse femrat duan thjesht të jenë të bukura dhe mundohem t'i nxjerrë sa më mirë, ashtu siç ato duan.

Nga bashkëpunimet që keni pasur me VIP-at, a ka pasur ndonjë hatërbetje në lidhje me çmimet e veshjeve?

Të them të drejtën, nuk më ka ndodhur kurrë kjo gjë, sepse dera e ateliesë sime ka qenë dhe është e hapur në 20 vite për të gjithë artistët. Janë të famshëm, por gjendja ekonomike i kushtëzoi artistët shqiptarë. Në veçanti në Shqipëri nuk është se kanë të gjithë mirëqenie apo pasuri të madhe, që mund t'i lejojnë



vetes edhe shumë lukse. Historikisht dera e ateliesë sime përveç se gjithmonë kanë ardhur dhe kanë paguar, ka qenë e hapur dhe për ata artistë që unë e kam ndjerë apo që kanë ardhur dhe kanë kërkuar ndihmën time jo vetëm në pagesa, por edhe duke mos paguar. Duke qenë se i përkasim artit, ne kemi bashkëpunuar për të sjellë gjëra shumë të bukura.

Ka pasur ndonjë moment që keni thënë "Boll, mjaft më"?

Sidomos këtë periudhë e them çdo ditë (qesh). Gjithsesi, unë e thashë edhe pak më lartë që kjo punë është jeta ime. Pa të nuk mund të jetoj dot. Ngushëlloj veten duke thënë "Boll, mjaft, s'kam për ta bërë më", por vazhdoj sërisht.

Jeni aventurier? Cila ka qenë aventura më e rrezikshme?

Nuk jam aventurier fare, madje thashë të gjithë kohën time ia kushtoj punës. Më pëlgen shumë të jetoj në mal, të shkoj atje, ndoshta të fle me çadër jashtë. Nuk para dal. Ndihehem mirë me grupin e miqve të mi.

Meqë jemi te miqtë, sa miq të shtrenjtë keni? A ju kërkojnë ndere?

Joni ka miq pafund, që kërkojnë edhe ndere, siç edhe unë kërkoj tek ta. Miku i vërtetë dhe që nuk të tradhton kurrë është Zoti dhe prindërit e tu. Fatqësisht babai im nuk ndodhet më, kështu që mikja

më e mirë është nëna ime.

Dilni për jetë nate?

Nuk frekuentoj fare jetë nate, ndoshta se kur isha më i vogël kam pas dal shumë, siç është moshë e atilë. Madje e kam shumë të vështirë, pasi jam person shumë i ndjeshëm, prekem shpejt dhe i evitoj këto festat e mëdha. Edhe nëpër dasma nuk para shkoj.

Dehesh ndonjëherë?

Nuk para pi alkool. Kur pi ndonjëherë, arrij ta kap veten shumë shpejt që të qëndroj tek gota e parë.

Një femër ideale si do ishte?

Femra ideale do ishte një femër që të më kuptojë, ta kisha krahum tim të djathtë dhe që të kishim një familje me shumë fëmijë.

Keni menduar të debutoni jashtë me stilimet tuaja?

Nuk është hera e parë që debutoj jashtë me punën time. Kam shkruar shumë herë jashtë në shumë evente të modës duke filluar nga "Vogue Italia", "Milano fashion week" dhe evente të tjera, që bëhen edhe në Amerikë e më gjerë, ku shkoj dhe debutoj me punën time.

Projektet tuaja të fundit?

Më sipër unë fola për projektin me të cilin po merrem aktualisht. Shumë shpejt fillon "Kënga magjike", "E diela shqiptare" dhe të gjitha spektaklet e tjera në "Klan" dhe jo vetëm. Do jetë një vit shumë i ngarkuar.



Elita nuk kursehet, ja çmimi marramendës i këpucëve të "Hirushes"

Dita e shumëpritur ku dyshja do të kurorëzojë dashurinë e tyre po afron. Në dasmë kanë ftuar miq të shumtë, për të cilët kanë përgatitur ftesa tepër të veçanta. Gruaja e ardhshme e reperit të njohur shqiptar, na mban te informuar çdo ditë duke publikuar lajme, foto dhe detaje interesante rreth organizimit të dasmës. Një nga detajet që Elita Rudi ndau me ndjekësit e saj në rrjetet sociale ishte paja që kishte përgatitur. Së fundmi, bukurshja ka publikuar foto duke treguar këpucën e hirushes që do të mbajë në natën e saj më të rëndësishme. Duket qartë se vërtet ato janë si këpucët e Hirushes përpos shumë të bukura, edhe me çmim marramendës që e paguan princi i kaltër.




Lori Hoxha mahnit fansat, zbuloni çfarë nuk di të bëj milionerja

Nëse jeni një ndjekës i fashionistes Lori Hoxha, mos u çudisni kur të shihni video-tutorial në profilin e saj në 'Instagram'. Kjo pasi Lori ka njoftuar se tashmë po ndjek një karrierë të re në fushën e makijazheve dhe sapo ka provuar të xhirojë një video-tutorial për herë të parë. Lori ishte ndër të paktat fashioniste shqiptare që nuk para postonte video. Por mesa duket, pas dasmës së motrës Sara dhe xhirimeve që realizoi atje, Lori po e mendon seriozisht të bëhet më tepër protagoniste. Ne jemi të lumtur që më në fund do të shohim sesi e bën makijazhin Lori, hap pas hapi.




Luana Vjollca 'ngec' në ashensor, kaq tërheqëse nuk e keni parë kurrë

Ajo është një nga modera Atoret më të dashura për publikun. Bëhet fjalë për Luana Vjollcën, e cila kohët ka treguar se është mjaft e dedikuar ndaj punës së saj. Shpesh herë ajo ndan me fansat e saj postime motivuese. Këtë herë ajo shfaqet tejet seksi nga ashensori. Luana është treguar entuziaste dhe mezi pret të ndajë projektet e saj të reja me publikun. Ndërsa moderatorja bëhet gati të prezantojë punët e saj, ne nuk na ngelet gjë tjetër veçse të shijojmë këtë foto mjaft tërheqëse.




Vajza i bëri pyetje për ndërhyrjet, reagimi i Klaudias do ju habitë

Për Klaudia Pepën sezoni veror ka qenë periudha e sulmimit nga fansat. Fotot e saj provokuese si dhe ndarja nga ish-bashkëshorti i saj Albi Nako e vunë në qendër të komenteve. Këtë herë kritika e një fanseje ka të bëjë me hundën e balerinës. 'Pse nuk e bën operacion hundën, e ke shumë keq' shkruan fansja. 'Më pëlqen siç e kam' i ka kthyer përgjigje Klaudia, shoqëruar me një puthje duke tentuar të jetë sa më miqësore edhe ndaj kritikave.



Gafa, Sekretari amerikan i Mbrojtjes pritet me fshesë në Maqedoni

Cfarë po ndodh me shërbimet protokollare në Qeverinë e Maqedonisë? Si duket vizitat e njëpasnjëshme kanë lodhur protokollin e organit ekzekutiv, saqë vonohen edhe në pritje. Sekretari amerikan i Mbrojtjes, James Mattis, e gjeti të papërgatitur delegacionin në krye me ministren e Mbrojtjes së Maqedonisë, Radmilla Shekerinska. Duke zbritur nga aeroplani, Sekretari amerikan Mattis u pengua nga ushtarët, të cilët ishin duke vendosur tapetin e kuq dhe po pastronin me fshesë, ndërsa përballë gjeti Shekrinskën dhe ambasadorin Xhes Bejtilli, duke vrapuar për ta pritur. Tashmë dihet se kjo nuk është herë e parë. Ditë më parë delegacioni i ministrit të Jashtëm të Shqipërisë, Ditmir Bushati u gjet në Kuvendin e Maqedonisë sikurse në një udhëkryq, pa u pritur nga kreu i Kuvendit, Talat Xhaferi.



Kate Middleton, një princeshë edhe para se të ishte në familjen mbretërore

Kate Middleton ka qenë një princeshë perfekte qekur u martua me William në vitin 2011. Por para se të martohej dhe të bëhej Dukeshja e Kembrixhit, ishte një vajzë shumë normale. Bente pazarin me një triko me kopsa, shijonte jetën e natës me miqtë, kalonte pushime verore fantastike. Sigurisht, me prejardhje nga një familje e pasur dhe e lidhur me princin do të thotë se nuk ishte saktësisht si kushdo tjetër, por fotot e saj të vjetra tregojnë jetën e Kate para se të hynte në familjen mbretërore. Kur u lidh me princin ishte e re dhe kohën më të madhe të rreth të 20-tave e kaloi në media teksa njerëzve u rritej interesi për të. Shihni në fotogaleri se si ka qenë Kate.



BULEVARDI

Në merrni seriozisht! 😊

POLITIK



Ministri gjerman feston ditëlindjen në Tiranë, surpriza e homologut Bushati

Ministrin e Jashtëm gjerman Heiko Maas e gjeti ditëlindja e tij e 52-të në vizitën zyrtare në Tiranë. Vetë homologu i tij, Ditmir Bushati, në një postim në "Instagram" na zbulon edhe surprizën që iu bë Maas nga ai dhe stafi i Ministrisë së Jashtme shqiptare. Mjaft i surprizuar duket Maas, ku sapo del nga takimi me Bushatin për të shkuar drejt sallës së konferencës, të gjithë i uronin ditëlindjen. Torta e ditëlindjes e gjen të papërgatitur Maas dhe sigurisht, mjaft të kënaqur për surprizën. Por nuk munguan as batutat. "Ta bëjmë dhe njëherë këtë në konferencën për shtyp", ka thënë ministri gjerman, mjaft i lumtur teksa i fryn dhe qiriut të tortës.



Rama zbulon kush fluturoi dje me "Air Albania", në avion edhe ministrja e Shëndetësisë

Pas studentëve të ekselencës, duket se radhën për të provuar "Air Albania" e kanë pasur pensionistët. Kryeministri Edi Rama ka zbuluar përmes disa fotove se në avion kanë hipur 100 pensionistë. Me ta është edhe ministrja e Shëndetësisë, Ogerta Manastirliu. "Sot (dje) 'Air Albania' fluturoi për 100 pensionistë", shkruan Rama entuziast. Mbetet për t'u parë se si do i shkojë "filli" kësaj kompanie fluturimesh, kaq shumë të reklamuar nga qeveria e personalisht kryeministri.



IN MEMORIAM

ALQI BOSHNIJAKU

E bija: Kam pengje, po e njoh përmes shënimeve që më la në libra

Fatmira Nikolli

Kur isha e vogël, më thoshin që babai im, Alqi është poet shumë i njohur. Atëherë nuk e rrokja madhësitë e tij. E kuptova me të vërtetë forcën e penës së tim eti, vetëm kur takohesha me shqiptarë në Greqi dhe prezantohesha si e bija. Shikoja në sytë e tyre respekt dhe admirim për tekste dhe këngëve që krijoi". Amoela Boshnjaku ndjen boshllëk kur kanë kaluar 20 vite pa të atin. Poeti e tekstshkruesi u nda nga jeta më 20 shtator të vitit 1998, ende i ri, me shumë projekte në duar dhe me një vullnet e pasion të madh për skenën e tingujt. Përmes rrëfimeve të familjarëve "GSH" synon të përkujtojë njeriun e artistin, babain e poetin, që gjurmët e tij të mos fshihen e që emri i tij të mos mbetet vetëm në arkiva. Shtysa për këtë shkrim u bë Anila Boshnjaku, që në një bisedë të rastësishme, kujtoi kushëririn e saj, që është ende kaq pranë në kujtimet e atyre që e deshën.

E BIJA

Dy dekadat pa të kanë qenë të vështira. Amoela kujton sot se kur babai i dha librin e parë, e këshilloi të lexonte dhe të kishte vullnet në jetë. Nuk e harron kurrë porosinë e tij që "një njeri pak i zgjuar po me shumë vullnet ecën me shumë në jetë, se sa një njeri shumë i zgjuar por pa vullnet". Kujton se babait i pëlqente shumë t'i dhuronte libra e në të tërë ata shënonte me penën e tij një mesazh për të në faqen e parë. "Kam lexuar shumë libra këto 20 vitet e fundit. Ajo që më mungon më shumë është që nuk arrita kurrë të bisedoj me të përndenjat që më krijuan faqet e librave dhe t'i them sa të drejtë kishte atëherë!". Të afërmit e mbajnë mend si një njeri shumë të dashur, të ndjeshëm. "Në sytë e tij lexohej dukshëm një dashuri ekstreme për vajzën dhe për nënën e tij. Por dashuria në konceptin e tij kishte një përmasë shumë më të

gjerë njerëzore. Kur e pyetën Alqin se cila është për ty dashuria më e madhe, ai u përgjigj: "Unë nuk do t'i klasifikoj dashuritë. Të duash do të thotë të duash një mik, një shoqe, të dashurën tende. Nuk ka vetëm një dashuri të madhe. Tani për tani, dashuria ime më e madhe është për vajzën time, Amoelën", thotë Anila Boshnjaku, kushërira e Alqit.

FAMILJA

Ai e mbante në portofol foton e saj dhe ua tregonte të gjithëve. "Hej, shiko çfarë vajze kam unë" thoshte duke u mburrur me vajzën e tij. Alqi ishte djali i madh i një familjeje të vogël për kohën, të përbërë nga i ati Fane, e ëma Eli dhe vëllai Arian. Zoti e bekoj Alqin me një vajzë, Amoelën që ishte pika e tij e dobët, dashuria më e madhe e jetës së tij. Shumë prej teksteve të këngëve të tij janë frymëzuar nga vetë jeta e tij, ndaj janë aq aktuale dhe me shpirt. Nëna ishte një tjetër

Amoela Boshnjaku: 20 vite pa të, kam mall dhe vonë e kam kuptuar kush ishte babai im



Alqi Boshnjaku me Pirro Manin

dobësi e Alqit, që e kishte idhull deri në fund të jetës. Nëna e tij, një grua zonjë e autoritare, e kujton Alqin si një djalë shembullor që e dëgjonte edhe në moshë të madhe. "Bënte shumë për mua, më respektonte shumë. Ishte korrekt (e sillte rrogën në shtëpi)",

thotë ajo, duke kujtuar e përbotur se Alqin e kishte edhe shok. "Ndanim opinionet bashkë. 'Simfonia e nënës', është kënga që e shpreh këtë dashuri të thellë...", thotë ajo. Familja kujton se Alqi Boshnjaku nuk ia thoshte fare për të ndihmuar në shtëpi. Për të

Anila Boshnjaku: Kohët kur këndonte "Beatles" me kitarë e vishte pantallona kauboj

vetëm arti kishte rëndësi. Punonte deri në orët e vona para ndonjë gote vere. Në kohën e festivaleve e humbiste rrugën për në shtëpi. Vinte në të gdhirë dhe fliste me një pasion të jashtëzakonshëm për këngët dhe organizimin e festivalit. Sot pa të, emocionet janë vetëm mall dhe dhimbja që vjen prej tij. Portretet e varura në mur, si çaste të ndalura në kohë, veçe e shtojnë mallin. "Veçanërisht mungesë ndjejmë në datën 25 dhjetor, dita e lindjes së tij. Na thoshte çdo vit, 'Jam i shenjtë unë, se kam lindur në një ditë me Krishtin'. Mungon humori i tij impromptu. Periudha e festivaleve është një trishtim i gjatë", thotë e bija.

LIRIA E TIJ

Ndërsa Anila Boshnjaku, kushërira e tij, flet



JETËSHKRIM, GJURMËT QË LA ARTISTI

Alqi Boshnjaku lindi në Sarandë më 25 dhjetor të vitit 1954 dhe u nda para kohe nga jeta më 20 shtator 1998. Pasi mbaroi Institutin e Lartë të Arteve në vitin 1978, punoi si regjisor i Estradës së Ushtrisë. Në fëmijëri është aktivizuar me grupet e këngës në Pallatin e Pioneerëve dhe fillesat e tij si regjisor i pati me grupet amatore të shkollave të mesme të Tiranës "Qemal Stafa" dhe "Sami Frashëri" vitet 1976-1979. Në vitet (1979-1989) ka shkruar dhe ka vënë në skenë premiera të estradave të Peshkopisë, Durrësit e Elbasanit si "O burra një burrë", "Shtëpia e zezë", etj. Ka qenë as regjisor në disa filma si "Emblema e dikurshme", etj. Me vendosjen e sistemit demokratik në Shqipëri,

Alqi u bë drejtues dhe inspirues i grupeve të para të muzikës moderne si "Art-ing" apo "Spirit Voice", etj. Nga viti 1990 deri në vitin 1998 ka qenë redaktor dhe koordinator letrar në të gjitha festivalet e këngës në RTV. Kulmi i krijimtarisë së tij artistike u shënuar me pjesëmarrjen si autor tekstesh në të gjitha Festivalet e Këngës dhe koncertet e Pranverës që nga viti 1990 deri në vitin 1998. Për cilësinë e penës së tij, për aktualitetin dhe mbi të gjitha ndjenjën që përcilnin tekste të këngëve është nderuar me shumë çmime kombëtare e ndërkombëtare. Këngët e shkruara nga Alqi Boshnjaku janë vlerësuar 8 herë me çmime të para. Kënga me titull "Larg urrejtjes", fituese e çmimit të parë në Festivalin e Këngës

në vitin 1997, e sjellë në skenë nga Elsa Lila, u kurorëzua edhe me çmimin "Grand Prix" në Varna, Bullgari, vetëm një vit më vonë. Edhe më tej, suksesit të kësaj kënge i shtohet çmimi i dytë i festivalit "Voice of Asia", i mbajtur më 30 korrik-5 gusht 1998. Ai ka bashkëpunuar me disa këngëtarë të njohur duke sjellë këngët: "Larg urrejtjes" Elsa Lila, "Mbi Mesdhe" Spirit Voice, "Emocion" Aleksandër Gjoka, "Të sotmen jeto" Mira Konçi, "Ti nuk më tradhton" Alma Bektashi & A. Gjoka, "Herezia" Françesk Radi, "Fal" Ledina Çelo, "Ike me Dallëndyshtë" Manjola Nallbani, "Emigranti" Irma Libohova, "Si banania" Dashnor Diko, "Dua të shkoj me atë që dua" Shirli Polena, "Të pranoj si je" A. Gjoka,

E. Deda, R. Makashi, "Kështu e ka jeta" Alma Bektashi, "Fuoristrada" Spirit Voice, "Pesha e Fatit" A. Gjoka, M. Nallbani, V. Tahiraj, "Mos u nxito" Anita Bitri, "Marinari" Ema Qazimi, "San Valentino" Ledina Çelo, "Simfonia e nënës" Sherif Merdani, "Kam frikë nga dashuria" Rovena Dilo etj. Aleksandër Gjoka është shprehur se për të, firma e Alqi Boshnjakut që një garanci për sukses. "Të gjitha çmimet e mia i kam të lidhura me të". Ndërsa Luan Zhegu e kujton si një njeri ekspresiv dhe pasionant i çmendur. "Kur bashkëpunojta me të, ngatërroja ditën me natën. Telefonat pas mesnate ma bënin të pasigurt gjumin dhe të sigurt suksesin".

ÇMIMET E PARA

1. "Mos u nxito", çmimi i parë, Festivali i Këngës në RTSH 1987.
2. "Emocion", çmimi i parë, Koncerti Pranverës 1993.
3. "Të sotmen jeto", çmimi i parë, Festivali i Këngës në RTSH 1994.
4. "Pesha e fatit", çmimi i parë, Festivali i Këngës në RTSH 1995.
5. "San Valentino", çmimi i parë, Koncerti i Pranverës 1996.
6. "Larg urrejtjes" çmimi i parë, Festivali i Këngës në RTSH 1997.
7. "Si Bananja" çmimi i parë "Këngët e stinës" 1997.

më shumë edhe për shpirtin e tij. "Ka qenë njeriu më i lirë që kemi njohur, që në kohën kur nuk ishte e lehtë të ishte i lirë... Në adoleshencë, i pëlqente të këndonte fshehurazi me kitarë këngët e 'Beatles', të Adrianos. Sa i ndjente ato! I pëlqente të mbante flokë të gjatë dhe pantallona kauboj. Për flokët e gjatë i dhanë një mase disiplinore në shkollë, ndërsa në Festivalin e 11-të të këngës, ku ishte në kor, pat veshur pantallona kauboj dhe për më tepër ngjyrë si vishnjë. Ato pantallona u zhdukën", kujton Anila. Ato që mban mend ajo, janë ditët e rinisë, kur Alqi Boshnjaku hidhte hapat e parë, qeshite, gëzonte, krijonte e rriste emrin e tij. "Si kushërinj e si shokë, e kam parë atë në ditë të mira e të vështira. E kam



parë duke qarë e duke qeshur të gëzuar dhe të helmuar, të pirë dhe të etur, të ngrënë dhe të uritur, të dobët dhe të fortë", thotë Anila. Mban mend se çdo çast Alqi mendohej ta kthente në art, në poezi, në muzikë e këngë. "Gjithmonë mendoja se në poezitë e shkrimet e tij gjeje një

shpirt si të John Lennon e Bob Dylan. Kush e ka njohur nga afër, do më japë të drejtë". Alqi ishte modern, me shpirt artistik dhe natyrë sportive. Ai nuk bënte vetëm tekste këngësh, por edhe këndonte shumë mirë. "Lajmi për aksidentin e Alqit erdhi i papritur, izi, ipabesueshëm. Dhe sot e kësaj dite nuk mund ta besojmë që Alqi nuk jeton. Përpiqemi të bindim veten se vetëm trupi i tij nuk është mes nesh dhe se shpirti, i gdhendur në vargje mbetet i pavdekshëm", thotë Anila.

Ai ishte njeri që falte, që dinte të pendohej. Nuk e hopenste trishtimin sepse fraza "Të sotmen jeto" ishte rregulli i tij. Bëhej mik me të gjithë, me bahçevanë, punëtorë, politikanë, biznesmenë e fëmijë. Të rinjtë i mbështeste jashtëzakonisht, u ka besuar me këngët e tyre të para...

Ky ishte prindi e artisti, shoku e kushëriri, biri e vëlai Alkqi Boshnjaku: një artist 360 gradë, që këndonte, i binte kitarës, bënte poezi, bënte regji, menaxhonte banda muzikore, por edhe luante futboll, ishte sallaks dhe tifoz i çmendur i gjermanëve.



Alqi Boshnjaku me artistë

SI E SHPËTOI HASAN NALLBANI XHAMINË E BEQARËVE NË KOMUNIZËM

Kur çështja e teatrove ko mbëtarë është në diskutim edhe pas më shumë se 90 ditësh protesta, arkeologia Etleva Nallbani sjell në kujtesë se si u shpëtua në komunizëm nga babai i saj xhamia e çmuar e Beqarëve. Përmes një postimi në facebook, ajo tregon se çnodi disa dekada më parë.

Postimi i plotë:
Manush Myftiu në 1968 donte të shembte xhaminë e Ethem Beut dhe insistonte aq shumë sa edhe më i madh ka qenë kundërshtimi i Gani Strazimirit, sa që çështja bëri shumë bujë. Por Ethem Beu shpëtoi...atëherë... Ndërsa po në atë vit, në Berat, ishte urdhëruar që të ekeputeshin minaret e xhamive dhe konkretisht ajo që do e hante e para ishte e ajo e Beqarëve. Punëtorët ishin caktuar dhe me litarë në duar kërkimin çelësin e



xhamisë. Çelësin e kish Hasan Nallbani dhe e kish fshehur, e ishte zhdukur vetë... Ndërkohë mer Ganiun në telefon i cili i tha: thuaj po pres atë bre... Dhe ja kështu shpëtuan vepra të rralla të artit osman në Shqipëri, nga ndërkrimi i mashës komuniste, "njeriut të ri". Ky ishte një nga dhjetëra detajet e përpjekjeve për ruajtjen e trashëgimisë kulturore, në ato vite çmendurie... të cilat po i mbledh të rrefyerë nga babi, kolegë e miq të babit e të trashëgimisë. Një pjese të tyre

i kam përjetuar edhe vetë. O Zot sa të shumëjtë janë atentatet ndaj trashëgimisë, ndaj njeriut të lidhur me vlerat historike! Do thoni janë detaje! Unë mendoj që kemi veçanërisht nevojë të njohim raste konkrete, shembuj të kurajos dhe dashurisë për arritjet historike, të cilat para së gjithash vinin jetën e njeriut në rrezik. Historia vazhdon, madje edhe ky episod vazhdon, por është një ordinizim komunistaqishpifur, sa që nuk dua t'ua shëmtoj.

64 ese për letërsinë

Nga Petro Lati

Letrarja e re, Kleitja Vaso vjen para lexuesit me librin "Fluturim" - përmes pasionit për të shkruar, punës këmbëngulëse, përkushtimit dhe natyrës kërkuese. Pa mëdyshje, Kleitja është pjesë dhe model i asaj elite të brezit të ri, që kërkon më shumë nga vetja se sa të tjerët, ka dinjitet e vizion, guxon, lodhet, por nuk ankohet dhe investon për të ardhmen e vet. "Fluturim" është një libër me ese, një lloj shkrimi që përmban informacione, opinione, këndvështrime, sugjerime, apo arsytime të ndryshme. Është një bisedë e mençur që e dëgjojmë nga një vajzë, e cila duket se di më shumë se ne, di të shprehë bukur ato që mendon e na mbërthen me forcën e fjalës së saj. Duke lexuar 224 faqe libri, apo plot 64 ese, njëherësh përkthyer edhe në anglisht, më duket se përjetoj reflektime nga jeta e përditshme, krejt e zakonshme, por edhe nga kultura e arti, historia. Nga autorë bashkëkohorë e klasikë, mite të lashta që trashëgojmë prej grekëve të hershëm, madje deri tek heronj filmash të ditëve tona, që vijnë si kumt dhe jo si ekzaltim a lektisje, por si mesazh i përvojave apo dëshitimeve në jetë. Autorja tërhiqet pa masë nga esesitë të njohur, ku vend të veçantë zë Rainer Maria Rilke, i lindur në Pragë, por i edukuar në perandorinë austro-hungareze, shumë popullor, i cili qëndron mes shkrimtarëve të traditës dhe atyre modernë. Në krijimtari esesitë është i lirë në mendimet e veta, megjithatë pesha e së vërtetës siguron qytetarinë e këtij lloji të letërsisë. Kleitja Vaso nxitet edhe nga Haruki Murakami - një shkrimtar japonez i shekullit të kaluar në vizionet për krijimtarinë, kur thotë: "Mendoj se puna ime është vëzhgimi i njerëzve dhe botës, por pa i gjykuar. Respektoj fuqinë krijuese të individit, por jo aftësinë e tij për të të coptuar!"



Kleitja Vaso citon një personalitet të njohur e burrë shteti, Çurçillin si mentor, kur thotë: "Nëse po ecën përmes ferrit vazhdo..." - si mesazh i guximit për të mos rënë në gjunjë, pavarësisht nga rrethanat, duke mos dashur që të tjerët të të marrin për dore, në një kërkim këmbëngulës të rrugëve të fatit.

Dhe më të citohej Volteri, Camy, Dos- tojevski, Tolstoi, Sartri, Markez, Bodler, E. Pamuk, W. Blake, P. Sornetino etj. - shkrimtarë e mendimtarë, filozofë e estetë, si pasuri e ideve të mëdha për njeriun, kohën, marrëdhëniet njerëzore. Ajo sheh kontrastin mes Biblës dhe artistit si raporte që përjashtojnë njëra-tjetrën: "Bibla i vesh njerëzit, kurse arti shfaq lakuriqësinë e tyre paqësore", ndërsa "gënjeshtra dhe mashtrimi i duket se është thelbi i historisë së Odisesë", duke e përqsuar me "qytetin e vet të dashur e qesharak...".

Mitologjia, apo vepra arti e shtynjë të gjykojë mëdyshjet e saj: Dafne e tmerruar nga prekja e Apollon - dy figura mitologjike në skulpturën e Berninit - arratiset duke u ngurtësuar, pra në një formë jetëgjatë, por e palëvizshme. Po autorese çfarë i bie të zgjedhë: Amerikën e bollshme me komoditet e bollëk, apo Shqipërinë e varfër, ku të duhet të punosh e të transformosh?! Është shumë interesante mënyra se si vijnë ngjarje artistike e kulturore të kohëve tona: diku - diku aktorja e njohur Julia Roberts pyet: "Ke parë ndonjëherë zemër njeriut", sikurse nuk mungojnë të vërteta të mëdha nga aktorë të njohur; ku të mbetet në mendje shprehja: Askush nuk e harron të vërtetën, thjeshtë bëhemi gënjeshhtarë më të zotë.

Ka ese të tjera ku Kleitja Vaso mrekullohet nga forca, dhuntitë, apo aftësitë e njeriut, që, sikurse vetë titulli i librit "Fluturim", ngrihen mbi të zakonshmen: Ajo merr shkas nga një foto, një moment në fluturim e sipër i M. Jordanit në kërkim të koshit. Është një kërcim i paparë, fantastik i basketbollistit të njohur që duket se ka sfiduar forcën e gravitetit. Ky është njeriu, këtë aspirano!

Në vendin tonë eseja si një lloj i letërsisë nuk ka ndonjë shtrirje të lakmueshme. Konica, Kadareja, Zeqo, në mos edhe ndonjë tjetër e kanë lëvruar herë pas here, ndërkaq ka një përfshirje të saj në shkencat sociale. Në Europë dhe më gjerë ajo është shumë e njohur dhe fillësat i ka që në vitin 1500 me Michel Montaignin në Francë dhe Francis Bacon në Angli. Eseja si një mënyrë e njohjes dhe kontrollit të diturive, e aftësisë së shprehjes letrare, argumentimit dhe maturisë në opinionet e shfaqura është pjesë e programeve në universitetet amerikane dhe ato kanadeze. Këtu e ka bazën e formimit Kleitja Vaso, e cila ka studiuar në universitetin e Georgias, në SHBA. Liria e vërtetë është diçka e brendshme, sikurse dhe shpëtim i njeriut. Ajo kujton Niçen kur pa një kalë të

goditej keqas nga i zoti. Kafsha e gjorë kish humbur lirinë dhe Niçe kish tendur ta shpëtojë, e kish mbajtur në krahë derisa dhe vetë kish rënë për tokë, gjë që i kushtoi 11 vjet në spitalin psikiatrik derisa mbyllti sytë. Autorja është një vëzhguese e hollë e realitetit dhe e njerëzve, pa identifikuar se kujt, apo për ku e ka fjalën, duke i parë si dukuri të përgjithshme, sepse e mira dhe e keqja, prozaikja e jeta vanitoze,

virtuti dhe keqdashja, miqësia dhe tradhtia janë dukuri, që i hasim kudo dhe njerëzimit i është dashur të harxhojë energji dhe shekuj për të bërë përpara dhe përsëri ato mbeten sfida të tij. Esët e Kleitja Vasos janë të llojit jo formal (pasi ka edhe ese të llojit formal), që karakterizohen nga elemente personale, si aftësia vëzhguese, shijet, përvojat, humori, fantazia dhe imagjinata, apo stili i këndshëm dhe shprehës konstatime me të vërtetë besues. "Ndryshimi është të brishtësia e foshnjës dhe në këtë butësi ka forcë për të ndryshuar, sepse ajo rritet nga dita në ditë, nga ana tjetër pleqtë me lëkurë të ashpër, si një lëkurë trangu. Ky ngurtësim shënon dhe fundin e tyre!"

E para ishte fjala, si komunikim, prosperitet e zhvillim shoqëror, bukuri shpirtërore që shprehet në art. Kleitja Vaso shkruan bukur dhe ka fjalor të pasur, si refleks i leximeve të shumta. "Fytyra e tij ishte si ajo e një zogu, syza me xhama tmerrësisht të trashë, të cilët bënin që kuptim e tij të dukeshin gigandë. Trupi i tij ishte një kombinim i çuditshëm midis një vajze të vogël nga mesi e poshtë dhe një burri të vogël nga mesi e lart, supe të ngushtë, bark i konsiderueshëm - një qenie mitologjike...". Përshkrimet të tilla më kujtojnë Edgar Poenë. Në librin "Fluturim" ka krahasime të gjetura dhe sidomos oksimor, antiteza, vërtet të arrira: "Muzeu i pafajësisë", "Aksidentet dhe heroina", "Dhimbje qetësuese", "Dashuri profane", "Dashuri luanësh dhe lepupsh". Një humor i lehtë buron në shkrimet e saj. Por gjithsesi ajo nuk i ka shpëtuar dot, tekut, frazës së gjatë, që të lodh dhe humbet kuptimin e saj në rreshtat e shumtë. Me sa duket, shkolla dhe vetë anglishtja e folur për vite me radhë kanë bërë punën e vet.

Raportimi / i Ditës

Lirimi i Ermal Hoxhës, “përplasje” avokat-prokurorori

Nga Lindita Çela*

(vijon nga faqja 1)

... Hoxhës, pasi kishte kryer fizikisht vetëm gjysmën e dënimit për veprat penale të “prodhimit dhe shitjes së lëndëve narkotike” dhe “pjesëmarrjes në organizatë kriminale”.

Vendimi i lirimit, të cilin BIRN e disponon, është firmosur nga gjyqtari i Gjykatës së Fierit, Piro Sota dhe mban datën 13 shtator 2018.

Ermal Hoxha- nipi i diktatorit Enver Hoxha u arrestua më 14 janar 2015 si pjesë e organizatës kriminale që kishte ngritur një laborator të prodhimit të kokainës në fshatin Xibrakë të Elbasanit. Ai u dënua me 10 vjet burg nga Gjykata e Krimeve të Rënda, ndërsa në Apel dënimi u reduktua me 1/3 në 6 vjet e 8 muaj burg.

Sipas vendimit të gjykatës, Hoxha kishte kryer fizikisht 3 vjet, 6 muaj dhe 5 ditë burg deri më 20 korrik 2018, kur dorëzoi një kërkesë për lirim me kusht në Gjykatën e Fierit. Pas përfundimit të 1.5 viteve nga periudha e paraburgimit dhe një uljeje 1 muajore dënimi për shkak të aktivizimit me punë në burg, atij i mbeteshin për të vuajtur edhe 1 vit e 6 muaj.

Në kërkesën për lirim me kusht, Hoxha pretendon se burgu e ka arritur qëllimin e riedukimit dhe se ai është i gatshëm të riintegrohet në shoqëri. Ai ka paraqitur edhe një kontratë për t'u punësuar si ekonomist në kompaninë Hera Company, e cila zotërohet 100 për qind nga bashkëshortja e tij, këngëtarja Rezarta Shkurta.

Lirimi me kusht parashikohet në nenin 64 të Kodit Penal, në rrethanat kur i dënuari ka “arsye të veçanta” dhe ka kryer % e dënimit në rastet e vendimeve mbi 5 vjet. E përfaqësuar nga prokurorori Asllan Barjamaj, prokuroria e Fierit e kundërshtoi kërkesën e Ermal Hoxhës me argumentin se ai nuk kishte “arsye të veçanta” dhe se



vepra e kryer prej tij përfshihej në format e sofistikuara të krimit në Republikën e Shqipërisë.

“Nuk ka asnjë provë ose të dhënë që i dënuari paraqet arsye të veçantë që mundet të ligjërojë lirin e tij para kohe dhe vënien e tij në provë...,” thuhet në kundërshtimin e prokurorit Asllan Barjamaj.

“I dënuari nuk paraqiti në gjykim asnjë deklaratë ku të tregojë pendim për veprimet e kryera dhe të kërkojë falje, nuk ka bashkëpunuar në asnjë moment me organet e drejtësisë dhe as nuk ka kryer ndonjë veprim tjetër që të krijojë bindjen se me punën dhe qëndrimin e tij është arritur rehabilitimi...,” shtoi prokurorori i Fierit.

Gjyqtari Pirro Sota i rrëzoi kundërshtimet e prokurorisë si të pabazuara. Ai e argumentoi vendimin e tij të raportet pozitive të drejtorisë së burgut të Fierit dhe Shër-

bimit të Provës, të cilat vlerësuan sjelljen e Hoxhës në burg si dhe mundësitë e tij për rehabilitim jashtë tij.

Gjyqtari përmend edhe kontratën e punësimit si një argument për riintegrimin e tij në shoqëri.

“I dënuari do të punësohet me detyrën e ekonomistit pranë shoqërisë “Hera Company, gjë e cila e ndihmon në rehabilitim e shpejtë,” argumenton gjykata.

Gjyqtari shtoi, gjithashtu, se i dënuari e ka plotësuar kushtin e vuajtjes së % të dënimit dhe se “me punën dhe sjelljen e tij gjatë periudhës së burgimit ka treguar se ia ka arritur qëllimit të edukimit të tij”.

Si “arsye të veçantë”, Gjykata e Fierit ka marrë parasysh gjendjen familjare të Ermal Hoxhës, i cili sipas vendimit është baba i dy fëmijëve të mitur:

“Ligjvënësi duke përdorur

shprehjen ‘arsye të veçanta’ ka bërë një vlerësim të përgjithshëm, pa i nominuar ato e duke e lënë në vlerësim të gjykatës sipas rrethanave konkrete që i paraqiten,” thuhet në vendimin e gjyqtarit Sota.

“Arsyet e veçanta nuk janë gjë tjetër veçse rrethanat konkrete, të cilat provojnë se me dënimin e vuajtur është arritur qëllimi për edukimin dhe i dënuari është i gatshëm të riintegrohet në shoqëri,” shtohet aty.

I pyetur nga BIRN, avokati i Ermal Hoxhës tha se liria me kusht është një e drejtë e klientit të tij, e garantuar jo vetëm nga ligji, por edhe nga precedentet e mëparshëm.

“Ne kemi konsideruar se plotësohen kërkesat e nenit 64 të Kodit Penal. Gjithashtu, kemi ndjekur praktikën e gjerë të gjykatave shqiptare lidhur me çështje të tilla, prej nga rezulton që rasti ynë për-

puthet më së miri me subjekte të mëparshme të ngjashme, por jo për nga publiciteti,” tha avokati Ermir Beta.

Ndërsa prokurorori që ndoqi çështjen në gjykatën e Fierit, Asllan Barjamaj tha se do ta apelojë vendimin.

“Pres që gjykata të zbardhë vendimin për të bërë apelin, por ne kundërshtuam kërkesën e bërë nga Hoxha pasi nuk mendojmë se ai ka përmbushur kushtet e nenit 64 që kërkon dispozita e lirimit me kusht,” -tha prokurorori për BIRN.

“Nga sa u tha në gjykatë, unë nuk besoj se ka prova të mjaftueshme që vërtetojnë pendesën për veprën penale për të cilën është dënuar apo ka dhe garanci që të vërtetojnë mospërsëritjen e veprës penale, por gjithsesi do të shohim vendimin e arsyetuar të gjykatës se ku është mbështetur për të dhënë vendimin e lirimit për rastin Hoxha,” -shtoi prokurorori Barjamaj.

Hetimi për grupin e përfshirë në laboratorin e prodhimit të kokainës në Xibrakë nisi në dhjetor 2014, pas informacioneve të mbërritura në Shqipëri nga autoritetet gjermane. Në janar 2015, Prokuroria e Krimeve të Rënda vuri nën akuzë 9 persona për trafikim të lëndëve narkotike dhe krijim të grupit të strukturuar kriminal.

Ermal Hoxha u akuzua si një prej personave kyç në dosjen e njohur si “Xibraka”. Sipas dosjes hetimore, roli i tij në grupin kriminal ishte transportimi i dy eksperteve kolumbianë të kokainës drejt laboratorit në Xibrakë të Elbasanit.

Prokuroria e Krimeve të Rënda akuzoi Genci Xhixën si drejtues të grupit kriminal të përfshirë në laboratorin e kokainës, por ai nuk u arrestua asnjëherë nga policia. Pas lirimit të Ermal Hoxhës, për këtë çështje mbeten në qeli dy shtetasit kolumbianë dhe Salmir Batku e Ilir Hyseni.

*Reporter.al

BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.
LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE
MOBILE DHE TABLET

KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE
DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID

MERRNI NE KOHE REALE
LAJMET E FUNDIT NE
APARATIN TUAJ



Dje në "Express"

Intrigat e takimit të Vjenës për ndarjen e Kosovës

Nga Albioneta Ademi

(vijon nga faqja 1)

... po bëjnë përpjekje që t'i pake-tojnë e të duken bashkëkohore. Derisa Presidentët e Kosovës dhe Serbisë po punojnë në mënyrë sekrete mbi ndarjen e Kosovës, në Vjenë disa personalitete të tjera, që nuk mbajnë përgjegjësi publike për idetë e tyre, të enjten e kaluar janë takuar për të diskutuar për idetë e politikanëve. Takimi është organizuar nga Instituti për Shkenca Humane (IWM), temë e së cilit ka qenë pikërisht ndarja e ndryshimi i kufijve të Kosovës. Përfaqësuesit e këtij instituti i kanë konfirmuar gazetës "Express" takimin e mbajtur më 13 shtator. Ky institut financohet nga qeveria e Austrisë, ajo e Çekisë dhe ajo e Polonisë. Mirëpo te lista e donatorëve dhe kontribuesve të tij figuron edhe emri i Alex Soros, djali i filantropit George Soros, i cili muajt e fundit ka zhvilluar disa lëvizje nëpër Ballkan, duke takuar në mënyrë jo shumë transparente krerët kryesorë të politikës në Serbi, Kosovë dhe Shqipëri. "Express" ka mësuar se në takimin e Vjenës kanë qenë 12 pjesëmarrës, figura të shquara të shoqërisë civile, shumë prej tyre të afërt me Presidentin Vuçiç dhe Presidentin Thaçi. Për këtë takim së pari kish-te shkruar në "Twitter" Petrit Selimi, drejtues i Sfidave të Mileniumit, i cili kishte lënë të kupto-het, pa dhënë shumë detaje se në Vjenë po udhëtonte për një takim interesant. "Negociata të rëndësishme, prapaskanave, për këmbim të territoreve", kishte shkruar Selimi. Bashkë me të, aty ide për ndarje ose jo të Kosovës kanë dhënë edhe figura të tjera si:

1. Wolfgang Petritsch (Fondacionit austriak Marshall).
 2. Gerald Knaus (Iniciativa për Stabilitetin Evropian).
 3. Stefan Lehne (Ish-diplomat austriak).
 4. Tim Judah (Gazetar).
 5. Petrit Selimi (Drejtuari i Sfidave të Mileniumit, ish-ministër i Jashtëm).
 6. Thomas Muhlmann (Udhëheqës i ekipit të Ballkanit në Ministrinë e Jashtme të Austrisë).
 7. Valerie Hopkins (Korrespondente rajonale nga "The Financial Times").
 8. Piotr Buras (Këshilli Evropian për Marrëdhëniet të Jashtme).
 9. Zsuzsanna Szelenyi (Politikane hungareze).
 10. Rosa Balfour (Fondacioni gjerman Marshall).
 11. Kristof Bender (Iniciativa për Stabilitetin Evropian).
 12. Ivan Vejvoda (Anëtar i përhershëm i IWM-së, drejtues i Projektit "E ardhmja e Evropës").
- Një burim i gazetës "Express", i afërt me këto struktura, ka treguar se disa prej pjesëmarrësve preferojnë ndarjet etnike. Më i



zëshmi në favor të ndarjeve etnike është ish-diplomati austriak, i konvertuar në biznesmen, Wolfgang Petritsch. Petritsch, përveç tjerash, aktualisht është pjesë e një studioje ligjore në Austri, e cila punon për Qeverinë e Serbisë, qeveri kjo që muajt e fundit mësohet t'i këtë ndarë 10 milionë euro për lobim për persona të ndryshëm me influencë në publik, ose OJQ të ndryshme. Petritsch, muajt e fundit, disa herë ka dalë me analizat e tij pro shkëmbimit të territoreve mes Kosovës dhe Serbisë. Ai e ka përkrahur idenë e shkëmbimit të territoreve që nga fillimi, ndërsa edhe ka arsyetuar se sa shumë do ta ndihmonte ndryshimi i kufijve arrijten e marrëveshjes mes Kosovës e Serbisë. Njëri prej figurave më të shquara nga shoqëria civile serbe, që mori pjesë në këtë takim ishte edhe Ivan Vejvoda, veteran i shoqërisë civile, i afërt me politikën serbe, si dhe me filantropin George Soros. Vejvoda është drejtues i projektit "E ardhmja e Evropës". Menaxheri i projektit, Dino Pasalic, e ka konfirmuar për gazetën "Express" mbajtjen e takimit javën e kaluar: "Një takim për marrëdhëniet mes Kosovës dhe Serbisë është organizuar nga Instituti i Shkenca Humane në Vjenë, më 13 shtator. Një numër i pjesëmarrësve kanë ndarë bindjet e tyre personale në kontekstin politik lokal, rajonal dhe ndërkombëtar", thuhet në përgjigjen e

IWM-së dhënë gazetës "Express". Përfaqësuesi i IWM-së nuk është përgjigjur për mënyrën se si financohet projekti në kuadër të këtij instituti. Gazetari i "The Economist", Tim Judah, i cili është ekspert i çështjeve Kosovë-Serbi, po ashtu e ka konfirmuar për gazetën "Express" pjesëmarrjen e tij në takim, por ka thënë se nuk ishte takim i ndonjë rëndësie të madhe. Judah thotë se në Vjenë u mbledhën gazetarë e opinionistë, të cilët folën për Kosovën dhe Serbinë, por nuk dhanë idenë për ndarje. "Dje kishim një diskutim të shkurtër për Kosovën dhe Serbinë dhe arrazhuam që të flasim për pjesë tjera të Ballkanit. Ishin anëtarët e organizatës dhe disa të tjerë të ftuar", ka thënë Judah për gazetën "Express". Autori i shumë librave për Kosovën dhe Serbinë, gazetarit Judah, ka shprehur opinionet e tij rreth idesë së ndryshimit të kufijve në Ballkan. Ai e shihet si të dëmshme një ide të tillë, që po promovohet nga Presidenti Hashim Thaçi dhe autoritetet në Serbi. Nuk dihet nëse ai akoma e sheh si të rrezikshëm lëvizjen e kufijve në Ballkan, rajon ky që gazetarit i "The Economist" e njeh mirë. Megjithatë, një ditë pas takimit në Vjenë, Judah ka dashur që mblidhjen ta paraqesë si të parëndësishme. Gazetari i ka thënë "Express"-it se në Vjenë kanë diskutuar lajmet e fundit që vijnë nga Kosova dhe Ser-

bia dhe asgjë më shumë. Pjesëmarrës të tjerë të këtij takimi "Express" mëson se kanë qenë Gerald Knaus dhe Kristof Bender nga Iniciativa për Stabilitetin në Evropë (ESD), Gazeta "Express" e ka kontaktuar z. Bender, i cili është zëvendës drejtor i ESI. Ai thotë se në takim është folur për shkëmbimin e territoreve, por që nuk mund të japë më shumë detaje, sepse takimi ka qenë jorformal. "Diskutimi ka qenë i fokusuar në idenë e ndryshimit të kufijve mes Kosovës dhe Serbisë. Shumica e pjesëmarrësve kanë argumentuar kundër kësaj ideje, duke dhënë arsye të ndryshme për qëndrimet", ka thënë Bender në një përgjigje me shkrim për gazetën "Express". Ai ka treguar se ky takim është mbajtur sipas rregullave të "Chatham House". "Chatham House" është një sistem, sipas të cilit një takim i mbajtur për ndonjë çështje kontroverze nuk guxon që asnjë nga pjesëmarrësit t'i publikojnë detaje ose të bëjnë komente mbi atë se çka kanë deklaruar të tjerët gjatë diskutimit. "Takimi në IWM në Vjenë ka qenë diskutim jorformal i njerëzve të interesuar për Kosovën dhe Serbinë. Meqë ka qenë i mbajtur sipas rregullave të "Chatham House", nuk mund t'ju jap detaje se kush, e çka ka thënë", thuhet tutje në përgjigjen e zvdrejtorit të Iniciativës për Stabilitetin Evropian, që operon në disa kryeqendra evropiane.

HOROSKOPI

DASHI

Mos lejoni që gjërat e vogla të shqetësojnë mendjen tuaj. Sot do të keni një dëshirë të theksuar për të fituar sa më shumë para. Atmosfera festive në shtëpi do t'i lehtësonte tensionet tuaja.

DEMI

Mos u bëni të zymtë dhe të dëshpëruar. Kini kujdes të mos përfshihen në marrëveshje të dyshimta financiare! Sot ju duhet të përqendrohni në nevojat e të tjerëve.

BINJAKET

Mos i humbni energjitë duke argumentuar diçka të panevojshme. Mos harroni se kurrë nuk fitoni asgjë nga një argument i kotë. Një marrëveshje e re financiare do të finalizohet.

GAFORJA

Investimet në aksione ju sjellin përfitime afatgjata. Aftësia juaj për t'u bërë përshtypje të tjerëve do të sjellë shpërblyeme. Disa prej jush do të ndërmarrin një udhëtim të largët.

LUANI

Mund të përballeni me disa kritika për shkak të tendencës suaj për të mos i vlerësuar të tjerët. Mbledhni ndjenjën e humorit në nivele të ulëta dhe do të shkoheni me syrë më pozitiv nga njerëzit që keni përreth.

VIRGJERESHA

Puna kreative dhe artet do t'ju relaksojnë. Trajtimi i financave duhet të bëhet me shumë kujdes. Dashuria është e pakufishme dhe sot ju do ta përjetoj atë në maksimum. Hapat e guximshëm do të shpërblehen.

PESHORJA

Sot do t'ju duhet të merrni një vendim të rëndësishëm, që do t'ju bëjë të tensionuar dhe shumë nervoz. Investimet duhet të bëhen me një perspektivë afatgjatë.

AKREPI

Një ditë e dobishme për të përmirësuar shëndetin. Armiqtë në punë mund të bëhen miq me ju sot vetëm për shkak të një personi të tretë. Mos e nxisni partnerin tuaj për të bërë veprime të pakëndësishme.

SHIGJETARI

Një shumë e papritur parash do t'ju ndihmojë që të paguani disa fatura të vonuara. Një udhëtim i shkurtër te të afërmit sjell një moment rehatie dhe relaksimi nga përditshmëria e trazuar.

BRICJAPI

Vullneti mund të shpërblehet sot ndërsa përballeri me një situatë shumë të ndërlikuar. Ju nuk duhet të humbni kockën ndërsa merrni një vendim shumë emocional. Ditë e mirë për pasuri të patundshme dhe transaksione financiare.

UJORI

Shëndeti mbetet i përsosur. Kontratat e reja mund të duken fitimprurëse, por nuk do të sjellin fitimet që dëshironit. Mos merrni vendime të nxituara kur bëhet fjalë për investimin e parave.

PESHQIT

Ditë e mirë për të komunikuar me njerëz të cilët i takoni shumë rrallë. Do t'ju besohen shumë përgjegjësi, të cilat do t'ju ofrojnë një pozitë të rëndësishme në kompani. Bëhuni më origjinalë në bisedat tuaja.

Pretendentët humbasin të parën

Siti tronditet në shtëpi nga Lioni

Lioni ka mundur 2-1 Manchester Siten në fushën e kësaj të fundit duke shkaktuar rezultatin më befalusës të mbrëmjes. Skuadra e Pep Guardiolas bëri kështu një nisje të pamenduar të aventurës në Champions League, kompicioni kryesor të cilin Sheikët që kanë investuar në skuadër duan të sjellin në "Etihad". Por në një mbrëmje të mbushur me surpriza në Manchester ishin miqtë nga Franca që befusuan

të zotët e shtëpisë, duke shënuar dy herë që në pjesën e parë për të siguruar tri pikët e para në grup, ndërsa një goli vetëm nga Bernardo Silva nuk mjaftoi për të ndryshuar fatin e ndeshjes. Siti e nisi shumë mirë takimin me dy raste të Rahem Sterling, por sulmuesi anglez nuk tregohet i saktë në të dy rastet, duke shpërdoruar mundësitë për të kaluar të tijtë në avantazh. Ajmerik Laporte vjen nga mbrojtja disa minuta më vonë pasi Siti kërkoi me ngulm golin e

parë, por goditja e tij me kokë u përplas në shtyllë. Në minutën e 26' është Lioni që befason vendasit kur Maksuell Kornet dërgon topin në rrjetë, por gjyqtari e anulon për pozicionin jashtë loje. Megjithatë, dy minuta më vonë goli i Kornet nuk anulohet, pasi mesfushori i krahut të djathtë nxirret i lirë nga një pasim i shkëlqyer i Nabil Fekir. Në minutën e 32-të Siti mendoi se kishte arritur të barazonte rezultatin, por goli i Ilkaj Gundogan u vlerësua i shënu-

ar nga pozicioni jashtë loje, në atë që me siguri do të konsiderohet si episodi më i diskutueshëm i mbrëmjes. Dhe si për të shtuar më tepër vuajtjet e Guardiolas dhe të tijve, Fekir shënon golin e dytë për francezët duke përfituar edhe nga dalja pak më shumë se sa duhej e Ederston nga porta. Në pjesën e dytë Siti u përpoq të bënte diçka më shumë, por vetëm një gol i Bernardo Silvas në minutën e 67 nuk mjaftoi për të ndryshuar rezultatin përfundimtar. Ndërsa



rastin më të mirë për barazimin e pati Sergio Agüero, i cili provoi me një gjuajtje

të fortë në hyrje të zonës, por që gjeti të përgatitur portierin kundërshtar.

Portugezi lë Juventusin me 10 lojtarë pas 29 minutash, por bardhezinjtë fitojnë 0-2

Real Madridi e nis aty ku e la, Ronaldo, karton të kuq mes lotësh

Kampionët thyejnë pa shumë probleme Romën



Jeton Selimi

Kampionët në fuqi të Real Madrid e nisnin mbrojtjen e trofeut të tyre duke fituar lehtësisht kundër Romës, me golat e Izkos, Bejlit dhe Marianos, që i dhanë suksesin 3-0 "Los Blancos". Që në minutat e para u pa se Reali do të ishte një shqetësim i madh për verdhekuqtë. Spanjollët kontrolluan lojën dhe krijuan disa raste goli, ndërkohe që Roma u kujdes vetëm që të mos lejonte hapësira. Por "galaktikët" dominuan dhe rasti i parë për Romën erdhi vetëm në minutën e 15-të. Gjithsesi kjo nuk krijoi asnjë shqetësim në skuadrën vendase, që mësu portën e mbrojtur nga Robin Olsen. Spanjollët dominuan në pjesën më të madhe të 45 minutave të para. Do të ishte çështje kohe kalimi në avantazh, i cili erdhi në minutën e 44-të. Goditje dënimi e ekzekutuar nga Izko dhe topi përfundoi mjeshtërisht në rrjetë. Pjesa e dytë nisi me një Romë ndryshe. Italianët patën një rast të mirë për të barazuar me anë të Under, por kostarikani Navas priti gjuajtjen e turkut. Reali u përgjigj me



një traversë të Bejlit. Por uellsiani e gjeti golin e tij në të 58-ën, pasi shfrytëzoi saktë pasimin Luka Modriçit

dhe fitoi duelin me portierin Olsen. Verdhekuqtë mund ta kishin shkurtuar disavantazhin pas gjuajtjes së

Kolarovit, por Navas ishte i pozicionuar mirë. Me dy gola avantazh, ekipi vendas ishte më i qetë. Gjithsesi ritmi i

LIGA E KAMPIONEVE		
GRUPI E		
Ajaks - AEK Athinë	3-0	
Benfika - Bajern Mynih	0-2	
GRUPI F		
Shakhtar - Hofenheim	2-2	
Manchester Siti - Lion	1-2	
GRUPI G		
Real Madrid - Roma	3-0	
Viktora Plzen - CSKA Moskë	2-2	
GRUPI H		
Valencia - Juventus	0-2	
Jang Bojs - an.Junajtid	0-3	

lojës nuk ndryshoi. Nga ana tjetër, Roma u përpoq më shumë, por ishte Reali që pati rastet më të mira. Në vazhdim, ai që tërhoqi vëmendjen ishte Asensio, që u dallua për klasike tij, duke marrë mjaft duartrokitje nga publiku. Por në kohën mbetur pati vend për një tjetër festim. Mariano, i cili debutoi me "galaktikët" shënoi golin e tretë të takimit në shtësi. "Zonja" arriti të triumfojë në Spanjë, pasi dy penallti të Miralem Pjanitç mjaftuar që Juventus të merrte tri pikët. Rezultati më surprizë i mbrëmjes së sotme është padiskutim humbja e Manchester Sittit në shtëpi kundër Lionit. Francezët triumfuan 2-1 në Angli dhe lanë "Qytetarët" në kuotën e 0 pikëve. Gjithsesi lajmi i ditës

ishte një tjetër. Ylli portugez, Kristiano Ronaldo, po bënte një ndeshje të shkëlqyer në 20 minutat e para debutuese me Juventusin në Ligën e Kampioneve. 33-vjeçari ishte shumë i lëvizshëm dhe sidomos në krahun e majtë, ku krijoi dy raste të pastra për gol. Por një episod i pakuptimtë dhe i pashpjegueshëm bëri që gjyqtari kryesor, Feliks Bruzh ta ndëshkonte portugezin me kartonin e kuq, në minutën e 29'. Ronaldo nuk iu besonte syve dhe mezi doli nga fusha e lojës. Mes lotësh dhe shumë diskutimeve, Kristiano u "dorëzua" dhe u largua drejt dhomave të zhveshjes para kohe, për herë të parë pas 154 ndeshjesh në Champions League.

Ajaksi ka mundur lehtësisht dhe me rezultat të thellë skuadrën greke të AEK-ut të Athinës, duke i mposhtur me rezultatin 3-0. Dy gola nga mbrojtësi Taljafiko dhe një gol i Van Den Bek kanë mjaftuar që gjigantët holandezë të marrin tri pikët e para në grupin e tyre. Në ndeshjen tjetër mes Shakhtar Donjeck dhe Hofenheim, nuk ka pasur fitues. Edhe miqtë gjermanë kanë qenë në avantazh për shumicën e takimit, janë barazuar dy herë nga vendasit ukrainas, që shpëtuan një pikë në limitet e takimit. Bajerni mposhti 0-2 Benfikën në transfertë, ndërsa Junajtid triumfoi bindshëm kundër Jang Bojs 0-3

Sulmuesi ndjen keqardhje për Luftëtarin

Bregu: Ndaj Tiranës e vështirë pa tifozë

Dejvi Bregu po shijon momentin e tij të mirë te Skënderbeu. Sulmuesit, të cilit i është besuar sulmi në Korçë, vlerëson në maksimum fitoren e arritur në Vlorë, ndërsa është i fokusuar në takimin kundër Tiranës në fundjavë, sfida që do të luhet me dyer të mbyllura. Gjithsesi, vlonjati ka dy fjalë edhe për ish-ekipin e tij, Luftëtarin, ekip në të cilin Bregu shpërtheu si futbollist.


Ndeshja kundër Fla-

murtarit: "Është një ndjesi tjetër, pasi luaja në shtëpinë time gjithsesi u mundova të bëj më të mirën. Ishte një ndeshje e vështirë, ashtu siç prishin. Ishte një sfidë nervash dhe ne në fund ia dolëm."
Aventura me Skënderbe-

un: "Ambienti në Korçë është shumë i lirshëm ndaj lojtarëve dhe ky mund të jetë një marsh më shumë për ne si lojtarë të rinj".
Mungesa e tifozëve kundër Tiranës: "Tifozët të japin një emocion tjetër dhe ky futboll lu-

het për tifozë, prandaj shpresojmë që të japim maksimumin".
Situata e Luftëtarit: "Më vjen keq për Luftëtarin që ndodhet në këtë situatë. Shpresoj që klubi dhe lojtarët të dalin me fitore në ndeshjen e ardhshme", u shpreh sulmuesi.

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

- Një pjesë e perandorisë
- Duhen marrë kolegjalisht.
- Qytet rus
- Fillojnë daljen.
- Të lë në mëdyshe.
- Një pjesë teatrale për të qeshur
- Është publiku i San Siros.
- Janë botimet e përmuajshme.
- Mbyllin aeroporte.
- Në krye të titullarëve.
- Ishte gruaja që i dha ujë nga pusi i Krishtit
- Bëjnë zoom të tillë.
- Inicialet e Kazan regjisor.
- Centrale Autonome Daneze.
- Është e kundërt e analizës.
- Qe mjeku i Mark Aurelit.
- Një enë
- Pulat pa kufij.
- Është për të ushqyer foshnjat me qumsh.

- Emri i Pirandellos.
- Një fjalë si akoma
- Në mes të Salt dhe City
- Jean që qe aktor.
- Mbyllin takimet
- Është edhe ajo e cirkut
- Kapiteni i Nautilus.
- ... mosketerët e Dumas.

VERTIKAL

- Një fjalë e pamjafveshme.
- Qe fabulist i famshëm
- Janë ciganët.
- Hapin vallen.
- Është influencim.
- Janë amatorët
- Pak ilaritet
- Një pjesë e mendimeve.
- Është budallaçka.
- Një fjalë e freskët.
- Një emër i njohur i modës.
- Me Odiseun u vodhi Palladin trojanëve.
- Elvira aktore.
- Pal... ish futbolist i yni.
- Një pjesë i dardanëve.
- Është marsejeze... për çati.
- Është ylli më i shndritshëm i Akrepit
- Liam aktor
- Mund të jetë një koncert.
- Kështu flet ai që është mbi kalë.
- Janë shtetet e ndara nga feja.
- Sean aktor.
- Stoker që shkroi Dracula.
- Një që bëhet si favor.
- Tre në Genesaret.
- Mbarojnë fare
- Diftong për serioz.


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


- Irene aktore.
- Gjysma e kulmit.
- Fillojnë vetëm.
- Qytet rumun
- Mund të jenë me sahat.
- Elliott Gould.
- Inicialet e Altman regjisor.
- Thomas Alva shpikës i famshëm.
- Lumë në Spanjë.
- Ndaheshin me sinorë.
- Zbuloi Tokën e Van Diemen.
- Kush nuk ka... nuk i ecën.
- Një kapak me titull.
- Inicialet e Turgeniev.
- Janë provat që administrohen.
- Na kanë paraprirë.
- Rubinstein që qe pianist.
- Fundi i një fukarai.
- Gardner aktore.

VERTIKAL


- Është material për qiri.
- Mali ku ngeci Arka e Noes.
- Fillojnë panikun.
- Një zakon.
- Gjysmë sistem.
- Janë zogj të verdhë.
- Në fund të krahut.
- Shkroi Michel Strogoff.
- Gjysmë egoist.
- Përbindëshi i labirinitit.
- Vertetojnë firma të tillë.
- Emri i Zola.
- Është si shtëpi.
- Mbyllin portat.
- Ka tribuna me shkallë.
- Mund të jetë telefonike.
- Charles që krijoi Gishton.
- Pineda e Garcia Lorca-s.
- Janë të palëvizshmet.
- Aty ku del kush bie në sy.
- Ashtu si jeton anakoreti.
- Coca... më e famshme.
- Janë të ndryshme në leje.
- Ente Civile Kavajë.
- Shkroi Misteret e Parisit.
- Beton pa kufij
- Kështu përfundon një princip.
- Inicialet e Cruise
- Kufizojnë lëvizjet.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

		8						5
	8		4	1	7			
				6	9	7		1
4	2		1					
3		7						
9		8					6	7
							3	
	7			2			9	
	9			5			8	

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

8	6	3	1	9	7	4	2	5
9	5	4	8	2	3	1	6	7
1	7	2	4	5	6	3	8	9
2	8	1	6	7	4	5	9	3
3	4	5	9	1	2	8	7	6
7	9	6	5	3	8	2	1	4
4	3	7	2	8	9	6	5	1
5	2	9	3	6	1	7	4	8
6	1	8	7	4	5	9	3	2

Argëtim filozofik

- Disa njerëz janë të vjetër në të 18-tat, disa të tjerë të rinj në të 90-tat. Koha është një kuptim që njeriu e krijoi.

- Buda nuk ishte budist. Jezusi nuk ishte i krishterë. Muhamedi nuk ishte musliman. Ishin të gjithë mësues që na mësuat të duam. Dashuria ishte feja e tyre.

- Është shumë më e lehtë të kontrollosh njerëzit që kanë të ardhura të ulëta, pak edukatë dhe aspak zë.

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm

9		11	7		8	1	3		16	1	15
14	8	5	3	4	5		4	4	2	18	2
8	4	2	14	8	10		11	1		10	3
13		12	3	13	13	3	1	2	1		3
6	4	8	10			18	2	4	6		2
3		18	2		15	6	18	2	1	6	
1		6	1	4		7	3	3		11	6
16	11	1		3	13	3	8		1	2	7
6	16	3		5	3	9		15	8	10	2
6		4	6	10	6	11		11	6	1	
3	4	14	3	1		10	3	1		10	3
12	3	1		3	4	3	5	16	2		1

- Shtë janë dëshmitarë më të saktë se sa veshët.
- Heracitus
- Kam mësuar shumë, thjeshtë duke dëgjuar njerëzit. Shumica nuk dëgjojnë kurrë. Ernest Hemingway

Thënie të mençura

- Është më mirë të shkoni diku në kohën e gabuar, se sa të prisni për fitesën.
- Privilegji i të qenit në gjendje të ndjehesh mirë në lidhje me veten, është dhuratë më e vlefshme që mund të zgjedhësh me kë do të qëndrosh.

PËRGJIGJET E FJALËKRYQEVË TË NUMRIT TË KALUAR

FJALËKRYQI (1)

ERASMI PAKETA
LORIS KUMARIT
UNIK SANPES
AAMESEIMORISE
RDEMEREEMETIMET
DELIKATEVLA
SARAFETRAÇER
PIRATIMOLINE
MIGENARENAT
BSENETERTIT
ANTAEETASAKRA
NARKRITTEMA

FJALËKRYQI (2)

PAZAR KABINET
IRONIMBETIMZ
TMKEKETRINO
TARITARTONION
TMTITANETINA
KASAMARITANE
ELIMANEDESHE
ESOLANAKTECE
TUBORGUEREO
ODSAAARENADIA
KANNSARADIEP
KENDEKATEETI



maiora premunt/ gjëra të mëdha na presin

ZGJIDH UET NË RAUNDIN E DYTË

5 Diploma Profesionale / 26 Programe Bachelor / 1 Program i Integruar



DP - DIPLOMË PROFESIONALE / BA - BACHELOR / MP - MASTER PROFESIONAL / MSH - MASTER I SHKENCAVE / ME - MASTER EKZEKUTIV / PINT - PROGRAME TË INTEGRUARA / DR - DOKTORATURË

FAKULTETI
I EKONOMISË BIZNESIT
DHE ZHVILLIMIT

FAKULTETI SHKENCAVE
JURIDIKE, POLITIKE
DHE MARRËDHËNIEVE
NDËRKOMBËTARE

FAKULTETI
I SHKENCAVE HUMANË
EDUKIMIT DHE
ARTEVE LIBERALE

FAKULTETI
I INZHINIERISË,
INFORMATIKËS
DHE ARKITEKTURËS

FAKULTETI
I SHKENCAVE
MJEKËSORE TEKNIKE

Adresa: Bulevardi Gjergj Fishta, Nd. 70, H.1, Tiranë, Cel. 068 20 16 616, info@uet.edu.al, www.uet.edu.al

